



D R I T A

“Drita lufton kundër errësirës kur ndriçon.”

KEPPLER

E PËRMUAJSHME FETARE - KULTURORE E KISHËS KATOLIKE

Prizren • Prill 2009 • Viti XXVI • Nr. 4 (174) • Çmimi: Kosovë 1€, Europë 2€, Zvicër 3SFR, SHBA \$2.50



Kryeapostulli
Shën Pjetri

FAQE 7


Përgatiti:
DON MARJAN MARKU



Takimi me familjet e
meshtarëve, rregulltarëve
dhe rregulltareve në
Zllakuqan

FAQE 10-11

Shkruan:
M. TEUTA AUGUSTINI



Si mundet varri i
zbrazët të jetë
argument i ri-
ngjalljes së Krishtit?

FAQE 18

Shkruan:
DON ALBERT DEMAJ



Puna - njetet, fitimi dhe shëlbimi

Don Lush GJERGJI

Njeriu është gjithnjë qenie në lidhje, marrëdhënie, shkëmbim, dhurim dhe komunikim, në kërkim të zhvillimit dhe të përparimit të gjithanshëm. Shi për këtë, çështja thelbore e çdo njeriu është si të jetë dhe të ketë marrëdhënie pozitive dhe konstruktive me vetveten, me të tjerët, me Zotin. Çfarë është cilësia e marrëdhënieve, e tillë është edhe jeta e njeriut, njeriu (krh. Mk 12, 28-34; Rom 13, 8-10). Puna është po ashtu një lloj marrëdhënie mes punëdhënësit dhe punëzbatuesit, për krijimin e ndonjë të mire, shërbimi, prodhimi, sidomos për krijimin e kushteve sa më të mira të punës dhe të jetës. Me këtë problematikë, në mënyrë mjaft sistematike dhe përmbytëse, është marrë papa Leoni XIII (1810-1903) në enciklikën e njohur “*Rerum novarum*” (15 maj 1891), që si temë boshte shqyrtimi ka “*çështjet sociale*” mbi të drejtat dhe detyrimet e punës dhe të punëtorëve sipas shpirtit ungjillor, bazë kjo për doktrinën sociale të Kishës Katolike. Papa Leoni XIII guximshëm dhe profetikisht mbron dinjitetin e njeriut – punëtorit, të varfërit, të drejtën e organizimit të punës dhe shumë çështje tjera mjaft aktuale. Ky botëkuptim begatohet dhe zhvillohet dukshëm edhe në enciklikën e papës Gjon Pali II (1920-2005) “*Laborem exercens*” (1981), si çelës kryesor për të kuptuar dhe zgjedhur shumë çështje shoqërore, kulturore, morale dhe fetare. Aty theksohen këto risi: “*ulerën e punës nuk e cilëson para së gjitha lloji i punës*” (nr. 6), sepse çdo punë është njerëzore, e si e tillë duhet trajtuar si të mirë, të nevojshme, të dobishme, domethënëse. Dimensionin i dytë të punës sipas Gjon Palit II është se “*nëpërmjet punës njeriu bëhet më tepër njeri*” (nr. 9), pra, e shpreh, dhuron dhe realizon veten në dobi të familjes dhe të shoqërisë. Dimensionin i tretë të punës sipas botëkuptimit të krishterë është e drejta e çdo njeriu për punë, *si mjet* i domosdoshëm për sigurimin e jetës, egzistencës, sipas shembullit që na ka dhënë edhe vetë Jezu Krishti (krh. GS 22), si bashkëpunim me Zotin dhe me të afërmin, *mbi të gjitha si mjet, mundësi shëlbimi*. Ky është edhe qëllimi kryesor i jetës njerëzore, pra, edhe i punës, shenjtërimi, amshimi, jeta e pasosur, kuptohet, nëse punohet dhe jetohej me përgjegjësi, përkushtim dhe dashuri.

Këtë botëkuptim e zhvillon edhe më shumë papa Gjon Pali II në enciklikën “*Centesimus annus*” (1 maj 1991) me rastin e 100 vjetorit të enciklikës “*Rerum novarum*”. Në këtë enciklikë papa Gjon Pali II shkon shumë më thellë dhe më larg në zbërthimin e punës duke e ndërlidhur atë dhe punëtorët me disa çështje aktuale: - *padrejtesitë në ndarjen e të mirave dhe pasurive natyrore mes vendeve të industrializuara dhe të varfra*. - *Shfrytëzimet e ndryshme të fuqisë punëtorë dhe të punës, njeriut, me qëllime të përfitimeve dhe pasurimit*. - *Tregu i lirë i punës, si dhe mbrojtja e punëtorëve, lirive njerëzore, familjare, kombëtare, fetare, kulturore dhe shoqërore*. - *Shqyrtimin e kapitalizmit dhe komunizmit, si dy botëkuptime, të cilat shpesh e shkelin njeriun, punëtorin, duke e bërë atë mjet apo vegël pune, fitimi, në kapitalizëm, apo shërbëtor ideologjie, duke ia mohuar të drejtat dhe liritë themelore njerëzore, në komunizëm*. - *Dallimi i mirëfilltë mes njetit dhe qëllimit, sepse puna është dhe mbetet vetëm mjet jete, e asesi qëllim, dhe në qendër duhet të jetë gjithnjë njeriu, familja, shoqëria, për një të tashme dhe të ardhme sa më të mirë*.

Kjo enciklikë përgatit shekullin e ri, ku puna do të duhej të jetë mjet, vegël, mundësi për krijimin e kulturës dhe qytetërimit të shërbimit dhe të dashurisë mes njerëzve dhe popujve – shteteve dhe ku njeriu do të trajtohet si i tillë, qytetar i barabartë i botës.

Në Kosovën tonë tashmë demokratike të lirë dhe të pavarur, një ndër vështirësitë e mëdha pa dyshim që janë papunësia, mërgimi i vazhdueshëm i rinisë, mungesa e perspektivës për të tashmen dhe të ardhmen. Punëtorët e paktë po ashtu kanë vështirësi, sepse mungon përkujdesja për kushte të punës, të sigurisë, mbrojtja e fuqisë punëtoare, e cila fatkeqësisht në shumë raste shfrytëzohet, kushhtëzohet, keqtrajtohet, pa ndonjë mundësi konkrete për mbrojtje dhe përmirësim.

Kisha, si Nënë dhe Mësuese, dëshiron edhe në këtë lëmi të jetës dhe të veprimtarisë të jetë në shërbim të të papunëve, të pambrojturëve, si “*zëri i ndërgjegjes njerëzore*”, duke ftuar të gjithë në solidaritet, mirëkuptim, bamirësi.

Ushqyes i urrej- tjes – predikues i Dashurisë

FAQE 14

Shkruan:
Don Marjan UKAJ

Intervistë me arkeologjen, shkrimtaren,
poeten, zonjën Edi Shukriu

Sot më shumë se kurrë
është e nevojshme t'i
afrohemi të vërtetës
historike

FAQE 12-13



E Enjtja e Madhe – Mesha e Krizmës (Shugurimi i vajrave)

Në javën e madhe, në radhën e përgatitjeve të shumta për festën e Pashkëve, një vend të veçantë e zë edhe mesha e shugurimit të vajrave, e cila e i mbledh dhe i bashkon të gjithë meshtarët rreth ipeshkvit të tyre në Kishën Katedrale. Në këtë meshë, meshtarët para ipeshkvit të tyre i ripërtëjnë premtimet që secili i ka bërë para ipeshkvit ditën e shugurimit dhe bëhet shugurimi i vajrave për të sëmure, për katekumen (kandidat të rritur për pagëzim) dhe krizma. Kjo ditë

është një gëzim i veçantë për gjithë meshtarët sepse pikërisht në këtë ditë përkujtohet edhe vetë themelimi i sakramentit të Meshtarisë dhe të Eukaristisë nga ana e Jezu Krishtit në Darrën e Mbramë.

Edhe në këtë vit, sikur edhe viteve të tjera, ipeshkvi i Administratës Apostolike të Prizrenit, mons. Dodë Gjergji, së bashku me pothuajse të gjithë meshtarët, u takuan të Enjten e Madhe pikërisht në Katedralen tonë të bukur, në Prizren, në ora 10:00.

Ishte një ditë e bukur, e cila me bukurinë e vet pasqyrore edhe gëzimin e meshtarëve për festën tyre. Në meshë, përveç meshtarëve vendas, kishte edhe kapelanë të KFOR-it amerikan, gjerman, italian, portugez dhe sloven. Pas meshës shenjte, ipeshkvi u shtroi të gjithëve edhe sofrën vëllazërore për të festuar së bashku. Famulltarët, pasi që morën vajrat e shuguruar, u nisën me plot vullnet për të kremtuar misteret e mëdha të pashkëve.

(Dritapress)



Meshtarët pas kremtimit të Meshës në krye me ipeshkvin mons. Dodë Gjergji



Festa e Pashkëve në Ipeshkvinë tonë

Njeriu, për të përjetuar të plotë gëzimin e një fakti apo ngjarjeje, duhet për të punuar dhe për t'u angazhuar në mënyrë që përjetimi i asaj të jetë sa më i madh dhe sa më i frytshëm për jetën e tij. Një gjë të tillë, në mënyrë të ndryshme, e bëjnë të gjithë besimtarët tanë gjatë kohës së kreshmëve në të gjitha famullitë e Ipeshkëvisë sonë, ku përmes pendesës, uratës, bamirësisë, pjesëmarrjes në sakramentet e shenjta dhe në ceremonitë liturgjike u përgatiten për të kremtuar dhe përjetuar sa më mirë festën e Ringjalljes së Zotit tonë Jezu Krishtit – Pashkët.

Përgatitja më intensive për këtë festë të madhe të Pashkëve filloi të Enjten e Madhe, ku i tërë kleri, regulltarët, regulltarët dhe një pjesë e popullit të Zotit, ishte bashkuar në krye me Ipeshkvin mons. Dodë Gjergji në Kishën Amë të Prizrenit për të kremtuar ngjarjen e themelit të Kishës dhe të Eukaristisë nga vetë Jezusi në Darkën e Mbramë dhe për t'i dhënë fillimit triditëshit të shenjtë, që paraprind festën e Pashkëve.

Ipeshkvi në pretkun e rastit, ftoi të gjithë meshtarët dhe të pranishmit që burimi i gëzimit të jetës së tyre, i shërbimit, i fljimit, i mohimit... të jetë i rrënjësor në Korpin dhe në Gjakun e Krishtit, i cili u flijua dhe vazhdon të flijohet për ne në Meshën Shenjte, dhe po të njëjtin gëzim dhe dashuri që përjetojmë – vijoi Ipeshkvi – duhet t'ia dhurojmë dhe dëshmojmë edhe vëllezërve tanë që i shërbejnë.

Pas pjesëmarrjes në Sofrën Eukaristike, të gjithë të kushtruarit Zotit dhe popullit, në rrugën e meshtarisë apo të regulltarisë, ishin të ftuar në sofrën vëllazërore, të shtruar nga Ipeshkvi dhe të përgatitur nga motrat Engjëlllore.

Si në Prizren ashtu edhe në të gjitha Kishat tjera në Kosovë, gjatë triditëshit të shenjtë besimtarët e moshave të ndryshme morën pjesë në ritet e mundimit dhe të vdekjes së Jezu Krishti që në mënyrë krejt të veçantë na paraqet Java e Madhe. Ajo që duhet theksuar dhe vlerësuar më së shumti, është se gjatë këtyre ditëve Kishat

ishin përplot me besimtarë të gjunjëzuar në adhurim para Kungimit Shenjtë, dhe, siç është traditë, në të Premten e Madhe deri në orët e mesnatës vinin besimtarë për të ruajtur, nderuar dhe falënderuar trupin e vdekur të Jezu Krishtit.

Vigjilia e Pashkëve, apo e Shtuna e Madhe karakterizohet me heshtje dhe meditim, por për disa edhe me angazhim dhe përgatitje për të mundësuar sa më mirë festimin dhe kremtimin e kësaj feste të madhe. Meshën e natës së Pashkëve, të cilën e karakterizon në mënyrë të veçantë Fjala e Zotit dhe simbolet e shumta siç janë: zjarri, qirinjtë, uji... e udhëhoqi ipeshkvi ynë mons. Dodë Gjergji në bashkëmëshim me meshtarë të tjerë.

Edhe meshën solemne të ditës së Pashkëve e udhëhoqi Ipeshkvi ynë mons. Dodë Gjergji. Ipeshkvi në pretkun e ditës së Pashkëve u fokusua më së shumti në ngjarjen e vdekjes dhe të Ringjalljes së Jezu Krishti, dhe qartas shpjegoi dhe theksoi risitë dhe vlerat që solli për mbarë nje-



Ipeshkvi mons. Dodë Gjergji, presidenti Fatmir Sejdiu dhe z. De Cernabo

rëzimin kjo Ringjallje.

Mesha e shenjte ishte në transmetim të drejtpërdrejtë nga Radio Televizioni i Kosovës, për çka edhe duhet falënderuar, sepse falë angazhimit dhe gatishmërisë së tyre, Meshën shenjte patën mundësi ta përcillnin edhe shumë njerëz që për arsye të ndryshme nuk patën mundësi të jenë të pranishëm në Meshë.

Kishën tonë me praninë e tyre e nderoi edhe presidenti i vendit dr. Fatmir Sejdiu, përfaqësuesi i EULEX-it Cernabo, përfaqësues tjerë politik, ushtarak dhe civil që kishin ardhur për të përgëzuar dhe festuar së bashku me

ne.

Pjesëmarrja e madhe e besimtarëve dhe mysafirëve të shumtë që kishin ardhur nga pjesë të ndryshme të Kosovës, për të përgëzuar dhe uruar Ipeshkvin, e bëri edhe më madhështore këtë ditë të gëzueshme dhe të lumtur të Pashkëve.

Të gjithë të pranishmëve ipeshkvi ju drejtua me fjalë falënderuese, duke dëshiruar që festa e Pashkëve të sjellë paqe, mirësi dhe dashuri në zemrën e çdo qytetari që jeton dhe vepron në Kosovë.

(Don Anton Ukaj)

16 Prilli – Dita e dyerve të hapura

Shkolla Loyola - Gymnasium hap dyert dhe zemrën për dashamirët e arsimit



Më 16 prill të këtij viti, oborri i shkollës Loyola-Gymnasium mirëpriti shumë vizitorë.

Që nga 16 prilli 2005, kur u vu gur-themeli i saj, kjo datë festohet si dita e shkollës, apo e quajtur ndryshe edhe si Dita e dyerve të hapura.

Këtë ditë dyert e shkollës janë të hapura për vizitorë, të cilët në përgjithësi nuk mund të vizitojnë një vend të tillë.

Caku i kësaj dite është që vizitorët të informohen më hollësisht dhe të kenë një pasqyrë më të përfërt, se si është i organizuar procesi mësimor dhe jeta në konvikt.

Shumë ndërmarrje, institucione organizojnë një ditë të tillë çdo vit, çdo 2 vite, çdo 5 vite apo një herë për ndonjë rast të veçantë, si për shembull në ndonjë përvjetor.

Mirëpo, shkolla jonë këtë e

bën çdo vit. Në përgjithësi vizita është falas, do të thotë vizitorët marrin pjesë në program dhe ka shpjegime të ndryshme, varësisht nga ajo çfarë ata janë të interesuar të dinë.

Programi u mbajt në amfiteatrin e shkollës i cili ishte i mbushur përplot me vizitorë dhe nxënës. Ndër të tjera kishte të ftuar edhe mysafirë nga Gjermania si dhe pjesëtarë të KFOR-it gjerman. Nuk munguan edhe përfaqësuesit e Kishës Katolike të Kosovës.

Kori, orkestra e shkollës si dhe orkestra e KFOR-it gjerman shfaqën disa pika muzikore, ndër të tjera, edhe himnin e Republikës së Kosovës dhe atë të Gjermanisë.

Këtë vit për herë të parë u ndanë diploma të gjuhës gjermane për 7 nxënës që iu nënshtuan testit të gjermanishtes, të cilët edhe e kaluan atë.

Tre më të mirët ishin: 1) Arian Shala, 2) Drilona Sejfullahu, 3) Qëndresa Sopaj.

Marrja e diplomave ua mundëson këtyre nxënësve që të studiojnë në cilindo universitet ku flitet gjuha gjermane.

Pas programit, vizitorët patën mundësi që të vizitonin si shkollën ashtu edhe konviktin.

Në klasa nxënësit ishin të organizuar në projekte të ndryshme. Interesim të madh zgjuan edhe kabinetet në të cilat u zhvilluan mjaft eksperimente. Madje, edhe salla e sportit ishte e mbushur me vizitorë, të cilët patën mundësi të ndiqnin aktivitetet të ndryshme sportive, ndër të tjera edhe alpinizmin.

Kështu, dalëngadalë aktivitetet filluan të përfundojnë, mysafirët të shpërndahen dhe shkolla t'i kthehet gjendjes së zakonshme.

(Arta Musolli)

Festa e Shën Gjergjit në famullinë e Stubllës dhe në Budisalc

Data e 23 prillit, domethënë festa e Shën Gjergjit martir, në kishën tonë lokale përkujtohet, apo kremtohet në dy famulli: në Lugun Drinit në famullinë e Budisalcit dhe në Karadak në famullinë e Stubllës, në kishën e vjetër. Që në të dy famullitë mesha kryesore u kremtua në ora 11. Në Stubllë mesha e udhëhoqi meshtari i ri, kapelani i famullisë së Velezhës, don Jeton Thaqi dhe me të bashkëmëshuan edhe disa meshtarë që shërbejnë në këtë anë. Ishte vërtet një gëzim i madh, sepse për këtë festë, si edhe për festat tjera, besimtarët vijnë gjithësesi nga fshati Stubllë, por edhe nga Letnica, Binça, Kabashi dhe Ferizaji. Don Jetoni me gjithë entuziazmin e tij foli për jetën dhe veprën e Shën Gjergjit, për rëndësinë e kohës së Pashkëve dhe për luftën që i krishteri duhet realizuar në jetën e tij kundër djallit, mëkatit dhe kundër të keqes. Edhe famullitari don Aleksandër Kola përshëndeti dhe falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje.

Po ashtu edhe në Lugun e Drinit, e pikërisht në famullinë e Budisalcit, festa e Shën Gjergjit u kremtua me një solemnitë të madh. Meshën e udhëhoqi patër Ndue Kajtazi, frat në kuvendin françeskan të Gjakovës. Ai në fjalën e rastit ua krijoi mundësinë besimtarëve që të njihen më për se afërm me jetën e këtij martiri dhe, duke folur pikërisht për thirrjen në martirizim, ai theksoi thirrjen e të krishterëve sot në dëshmi. Kjo është edhe kuptimi i saktë fjalës martir – të jesh dëshmitar i Krishtit të ringjallur. Edhe famullitari i kësaj famullie don Albert Krista, i përshëndeti dhe i falënderoi të pranishmit duke i uruar në mënyrë të veçantë ata që e mbajnë emrin e këtij shenjtë dhe martiri të madh që e ka Kisha. Edhe kjo festë përfundoi me gëzim të madh dhe me drekën solemne të ofruar nga famullitari e të përgatitur prej motrave të zellshme françeskane të Zojës se Papëryler.

(Dritapress)

Kaloi në amshim nëna e mons. Hil Kabashit



Të enjten më 23 prill në moshën 93-vjeçare vdiq Gjyste Karica, nëna e monsinjor Hil Kabashit dhe e motrës Hilda Karica. Nëna Gjyste ishte një grua shumë e devotshme, i fali Kishës një djalë që është ipeshkëv në Shqipërinë e Jugut, mons Hilin, dhe një motër nderi, motrën Hilda. Nëna Gjyste si pak kush jetoi gati një shekull të tërë.

Në meshën e dritës morën pjesë katër ipeshkëvinj, mons. Zef Gashi, arqipeshkëv i Tivarit, mons. Dodë Gjergji, ipeshkëv i Kosovës, mons. Lucian Avgustini, ipeshkëv i Sapës, dhe biri i saj mons. Hili. Në meshën shenjtë

të dritës morën pjesë shumë besimtarë të Velezhës dhe më gjerë. Meshja e dritës u mbajt në kishën e shën Kollit në Velezhë. Ritet mortore i udhëhoqi mons. Lucian Avgustini i cili kishte ardhur nga Shqipëria. Pos numrit të madh të besimtarëve në varrim morën pjesë edhe shumë meshtarë të Kosovës. Varrimi i nënës Gjyste u bë në varrezat e Velezhës. Rallë kund ndodh që ndonjë besimtar të përcillet në amshim me katër ipeshkëv e shumë e shumë meshtarë e motra të nderit. Në fund të pranishmit i falënderoi mons. Hili për pjesëmarrjen në varrimin e nënës Gjyste.

(Dritapress)

Provinciali i ri nga kuvendi françeskan i Gjakovës

Në kapitullin e rregullt të mbajtur në Sarajevë, të mërkurën, më 22. prill 2009, për provincial të provincës françeskane të Bosnjës u zgjodh P. Lorenci. Këtë detyrë do ta ushtrojë sipas rregulloreve për gjashtë vite.



Patër Lovro Gavran

Biografia e shkurtër e P. Lorencit:
Vendlindja:
Veliki Prnjavor, fam. Foča (Doboj)
Datëlindja: 18. 02. 1954
Baba: Petar
Nëna: Anda, l. Ešegović
Noviciat:
Humac dhe Visoko, 1973-1975
Kushtet solemne:
G. Dubica, më 13. 04. 1980.
Shug. diakonal:
Sarajevë, më 14. 12. 1980.
Shug. meshtarak:
Gjakovë, më 29. 06. 1981.

Për ta mësuar gjuhën shqipe, në Gjakovë erdhi që para shugurimit meshtarak. Si kapelan ka shërbyer Vogovën, Moglicën, Korenicën dhe Osek Pashën. Famullitar dhe gardian ishte pas p. Gjellit, më 1988-1991. Ndërtoi kapelën në Osek Hilë

(1989). Filloi ndërtimin e kuvendit të ri françeskan, në kishën e shën Antonit (1990). Filloi botimin e fletushkës "Bashkësia jonë" (1991). Në vitin 1991 e dorëzoi famullinë dhe gardianatin – për të shkuar në Shqipëri, ku ishte vice-delegat gjeneral për Provincën Françeskane Shqiptare (1991-1995). Pastaj u bë famullitar në Iballë të Pukës (1995-2001), ku ndërtoi kishën e re dhe kuvendin. Njëkohësisht ishte edhe definitori i Provincës Françeskane Shqiptare. Më 9 maj 2001 u kthye prapë në Gjakovë. Nga viti 2006 zgjidhet definitori i Provincës Françeskane të Bosnjës. Më 22. 04. 2009 – zgjidhet provincial i Provincës Françeskane të Bosnjës. Redaksia e Dritës P. Lorencit i uron punë të mbarë dhe shumë bekime dhe hire prej Zotit!

(Dritapress)

Inagurohet shtatorja e Nënës Tereze në oborrin e kishës, donacion nga Gjon Prek Lleshi

U kremtua festa e Zojës së Këshillit të Mirë në Klinë

Të dielën e 26. prillit famullia e Klinës ishte në kremte të dyfishtë. Me mijëra besimtarë nga të gjitha famullitë e Kosovës kishin ardhur për të kremtuar festën e “Zojës së Këshillit të Mirë”. Ishte edhe një arsye më shumë që kjo festë të mbushej me entuziazëm e kënaqësi, nga shkak se po këtë ditë feste në oborrin e kishës u bë shpalosja e shtatores së Nënës Tereze, dhuratë kjo dhe donacion i birit të kësaj famullie Gjon Prek Lleshaj, i cili tani jeton dhe vepron në Amerikë. Moti i mirë dhe gëzimi i brendshëm i kishte shtyrë shumë besimtarë ta ngulitnin e të qëndronin palëvizur në shenjë nderimi të thellë e me shikim para altarit, duke pritur fillimin e ceremonisë, e cila për shumë kohë do të mbetet e regjistruar në kujtesën e tyre. Në fillim të meshës besimtarët e shumtë i përshëndeti famullitari i famullisë së Klinës don Lenc Sopi, i cili nga zemra e uroi donatorin dhe familjen e tij Lleshaj për këtë dhuratë të çmueshme, e cila ua shtoi buzëqeshjen dhe gëzimin e festës së shumë besimtarëve klinas e me gjerë. Para se të fillonte mesha, shpalosjen e shtatores e bënë: ipeshkvi i ipeshkvisë së Sapës dhe Zadrimes mons. Lucian Augustini, don Lenc Sopi dhe Prekë Lleshi në emër të familjes Lleshi.

Meshën solme e udhëhoqi Ipeshkvi mons Lucian Augustini, i cili enkas kishte ardhur nga Shqipëria për të ndarë gëzimin me besimtarët e kësaj famullie. Ai tha gjatë predikimit ndër të tjera: “Sot po festojmë festën e Nënës sonë Qjellore, Virgjërës Mari. Por para nesh del në pah edhe figura e të lumes Nënës Te-



Mons. Lucian Augustini gjatë kremtimit të Meshës në Klinë



reze, bijës se këtij kombi, e cila edhe sot na fton që ne kurrë mos të ndahemi nga lutja, urata dhe rruzarja në veçanti”. Në meshë ishin të pranishëm shumë personalitete e përfaqësues të KFOR-it dhe organizatave karitative, por kishte të pranishëm edhe vëllezër nga Shqipëria dhe nga të gjitha viset e Kosovës. E veçanta e kësaj feste ishte edhe fakti

i rregullimit të terësishëm dhe përgaditja e kishës se madhe për meshë pas një punë të njemendë dhe plot sakrificë të famullitarit të kësaj famullie don Lenc Sopi. Pas përfundimit të meshës kryesore, shumë besimtarë vëreheshin duke i bërë respekt kësaj shtatoreje të bijës së madhe të kombit tonë Nënës Tereze. Pra, dita e 26 prillit 2009 do të mbe-



Mons. Lucian Augustini bekon shtatoren e Nënës Tereze në Klinë



tet një ngjarje e shënuar për këtë popullatë dhe këtë famull, e cila tani e pas do të ketë mundësinë t'i lutet njëkohësisht Nënës se Kishës Virgjërës Mari dhe të lumes Nënës Tereze, nënës së të varfërve.

Për meshtarë, për motra të nderit, për seminaristët dhe për një numër besimtarësh të ftuar, famullitari don Lenci dhe ka-

pelani i kësaj famullie don Pali, shtruan sofrën vëllazërore ku këtë gëzim e shtonte edhe një program i përgatitur nga fëmijët dhe të rinjtë e famullisë. Për të gjithë kjo ditë qe një moment gëzimi dhe feste.

(Vilson Culaj)

Në Vogovë kremtohet festa e shën Markut ungjilltar

Në filialin e famullisë së Gjakovës, në Vogovë, u kremtua festa e shën Markut ungjilltar. Meshën e udhëhoqi famullitari i famullisë shën Jozefit në Pjetrashan don Tomë Karrica. Së bashku me don Tomën në meshë koncelebruan edhe Patër Marek,

meshtar nga Sllovakia, me shërbim në Shqipëri, don Jeton Thaqi, kapelan në Velezhë dhe Patër Ambroz Ukaj. Një grup tjetër meshtarësh ishin të gatshëm edhe për rrëfim.

Don Toma gjatë predikimit foli për figurën e shën Markut

ungjilltar dhe martir. Theksin e veçantë e pati në rëndësinë e njohjes të Shkrimit Shenjt. Shën Marku me kujdes i mblodhi të gjitha fjalët e shën Pjetrit gjatë predikimeve të tij dhe kështu e shkroi Ungjillin, që ne ta njohim më mirë figurën dhe veprën e



Don Tomë Karrica udhëhoq Meshën shenjte në Vogovë



Shpëtimtarit të vetëm të botës-Jezu Krishtit. Populli e përcolli me vëmendje predikimin e meshtarit. Dhe ishte kjo ditë e bukur me diell dhe më një pamje të natyrës se mahnitshme. Për këtë mijëra besimtarë kishin

ardhur për të marrë pjesë në Meshën e shenjtë. Besimtarët para dhe pas meshe i vizituan edhe varrezat e të dashurve të vet në Vogovë.

“KALVARI” në regjionin Abruzzo (Itali)

Tërmet, vdekje, plagosje, shkatërrim dhe mijëra familje të evokuara. Janë afër 300 viktima, 2500 të plagosur dhe 28000 të pastrehë prej kësaj tragjedie që e goditi këtë regjion të Italisë. Qytete e fshatra të shkatërruara, ku ndihma e zjarrfikësve, ushtria, spitalet dhe njerëzit që vraponin për t'i dalë në ndihmë njerëzve, që gjendeshin nën gërmadhat e shtëpive, të cilët thërrisnin; dikush përgjigjej, por kjo përgjigje filloi të shuhej në ditët që vijonin, duke e rritur gjithnjë numrin e viktimave.

Ngritën tendat për t'i bërë strehë fëmijëve, të moshuarve, tendat shërbejnë edhe si shkolla, kisha, kopshte për fëmijë, ndihmë arrijnë nga mbarë Italia dhe shtetet tjera të botës me njerëzit

ekspertë në këto tragjedi për të shpëtuar sa më shumë jeta njerëzish. Për ditë të tëra toka dridhej vazhdimisht dhe kjo i ka vështirësuar kërkimet nën rrënojat e tërmetit.

Dëgjoheshin thirrje: por përgjigjet ishin të pakta. Nuk kanë munguar as kritikët ndaj ndërtimeve të brishta që bëhen në zonat e rrezikuara nga tërmetet. Aquila është edhe një qendër e njohur universitare internacionale dhe fatkeqësisht në një konvikt kanë mbetur 40 studentët të vdekur.

Papa në shenjë solidariteti ndaj Kishës së Aquiles (Shqiponjës) të Enjtën e Madhe ia dërgon Arqipeshkvit të vendit Vajrat e Shuguruar, pasi që nuk ka mundur t'i mbledhë meshtarët

për të kremtuar ritet e Enjtes së Madhe. Në ritin e salikimeve kanë marrë pjesë kryetari i Italisë Napolitano, Kryeministri Berlusconi, Kardinal Bertone Sekretari i Shtetit të Vatikanit dhe delegacione të tjera e ambasadorë. Papa i ka përkujtuar edhe në lutjet e Javës së Madhe gjitha viktimat e tërmetit në mënyrë të veçantë.

Aquila e ka në gjak dhimbjen që i ka përcjellë me përvojat e dhimbshme të tërmeteve, duke u nisur nga ajo e vitit 1337, si dhe nga ajo e vitit 1703. Shpresojmë që edhe këtë herë populli i Aquiles do t'i përballojë të gjitha vuajtjet nëpërmjet solidaritetit të tërë botës që e dëshmoi ndaj dhimbjes natyrore që u është shkaktuar.

Katedralja Abruzzo-s, e dëmtuar nga tërmeti



Pashkët në Jerusalem

Në Varrin e Shenjte në ora 7 e 30 filloi procesioni i udhëhequr nga patriarku latin Fuad Twal, që e fillon Meshën në një hapësirë shumë të vogël në Varrin e zbrazet të Jezusit. Në ora 8 një procesion i tjetër i ortodoksëve sirianë dhe në ora 8 e 30 procesioni i ortodoksëve grekë. Për ortodoksët ishte e diela e Larit, ndërsa për katolikët ishte e Diela e Pashkëve një përputhje që ndodh sipas kalendarit çdo 4 vjet.

Në Bazilikë gjinden edhe françeskanët me një dekret të

“status quo” që është një dekret i mesit të viteve 1800 të nxjerrë nga Sulltani për t’u dhënë fund luftërave mbi kontrollin e vendeve të shenjta në Jerusalem ndërmjet konfesioneve të ndryshme. Por kjo “status quo” në realitet nuk e ka ndaluar dhunën në mes konfesionëve që në mënyrë anakronike vazhdojnë edhe sot. Me festën e Pashkëve është dhënë lajmi i vizitës së Papës në Tokën e Shenjtë, kështu që përgatitjet kanë filluar për t’i pranuar sipas parashikimeve rreth 40.000 shtetgarë.

Kulla e Davidit në Jerusalem



Papa Benedikti XVI u uron besimtarëve katolikë në gjithë Botën festën e Pashkëve



Ati i Shenjtë jep bekimin Urbi et Orbi

Nga ballkoni i Bazilikës së Shën Pjetrit, Papa ka uruar në 63 gjuhë të botës, mes të cilave edhe në gjuhën shqipe, *‘Gëzuar Pashkët’*. Në Bazilikën e Shën Pjetrit Papa Benedikti i XVI-te kremtoi Meshën e Pashkëve si dhe dy herë transmetoi mesazhin Urbi et Orbi *“për qytetin dhe botën”*, duke kërkuar fundin e luftës dhe të varfërisë në botë. Për konfliktin izraelito-palestinez, si dhe për konfliktet tjera në mbarë botën, Papa Benedikti tha se

zgjidhja më e mirë janë dialogu dhe pajtimi, bëri thirrje për krizën financiare që është duke i goditur familjet e tëra në mbarë botën, e cila është një kërcënim për ardhmërinë e familjes që më së shumti në shekullin XXI është në krizë. Në mënyrë të veçantë Papa iu drejtua viktimave të tërmetit që goditi Italinë në regjionin Abruzzo (Aquila) ditën e hënë ku më shumë se 294 persona gjetën vdekjen.

Agjenda e Papës

Mësuesi i Kremeftimeve Liturgjike Mons. Guido Marini ka publikuar agjendën e Benediktit XVI për muajin prill edhe për muajin maj.

- Më 26 prill në të dielën e III të Pashkëve në Bazilikën e Shën Pjetrit në Vatikan është bërë kanonizimi i 5 të lumturve: Arcangelo Tadini, (1846-1912, meshtarë, themelues i Kongregatës së Motrave të Shtëpisë së Shenjte të Nazaretit); Bernardo Tolomei, (1272-1348, Abat, themelues i Kongregatës së Shën Marisë së Monte Oliveto, të Rendit Benediktin); Nuno de Santamaria Álvares Pereira, (1360-1431, rregulltar, i Rendit Karmelitan); Gertrude Comensoli (1847-1903, virgjër, themeluese e Institutit të Motrave Sakramentine); Caterina Volpicelli (1839-1894, virgjër, themeluese e Kongregatës së Shërbëtorëve të Zemrës së Shenjtë).
- Në agjendën e Papës është edhe shugurimi i xhakonëve të Dioqezës së Romës më 3 maj në Bazilikën e Shën Pjetrit në Vatikan.
- Ashtu si është bërë e njohur nga mediat, Papa do të udhëtojë në Tokën e Shenjte, në Izrael nga 8 deri më 15 maj, ku do të realizohet udhëtimi i pritur me vite në Izrael, Jordani dhe në territoret palestineze.
- Ndërsa më 24 maj, ditën e të Ngriturit të Krishtit në Qiell, Benedikti XVI, do ta ketë vizitën pastorale në Montecasino, në abacinë e famshme të themeluar nga Shën Benedikti.

Papa pret Sekretarin e Përgjithshëm të Lidhjes Arabe

Nënshkruhet Memorandumi i Mirëkuptimit



Më 24 maj Benedikti XVI priti Sekretarin e Përgjithshëm të Lidhjes Arabe, Amr Musa. Në takimin e përzemërt u diskutua mbi gjendjen në rajonin e Lindjes së Mesme e mbi argumente të tjera me interes dypalësh. Dje paradite, në Pallatin Apostolik në Vatikan, u nënshkrua Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Sekretarisë së Shtetit dhe Lidhjes së Shteteve Arabe. Për Selinë e Shenjtë, nënshkroi Sekretari për Marrëdhëniet me shtete, imzot Dominik Mamberti, ndërsa për Lidhjen Arabe, Sekretari i saj i përgjithshëm, Amr Musa. Kjo marrëveshje e re e konsolidon më tej bashkëpunimin ndërmjet Vatikanit dhe Lidhjes, sidomos në nivelin politik e kulturor, në favor të paqes, të sigurisë e të qëndrueshmërisë rajonale

e ndërkombëtare. Gjithashtu, Memorandumi propozon mjete konsultimi ndërmjet palëve, duke treguar vëmendje të veçantë për iniciativat e dialogut ndërfetar. Të dëgjojmë nuncin apostolik në Egjipt, kryepeshkvën Majkell Fichherald, i cili është edhe legat i Selisë së Shenjtë në Organizatën e Lidhjes së Shteteve Arabe: Ky Memorandum Mirëkuptimi sigurisht që konsolidon marrëdhëniet ndërmjet Selisë së Shenjtë dhe Lidhjes Arabe. Ai përcakton dy fusha bashkëpunimi: kërkimin e paqes – veçanërisht kjo i intereson Selisë së Shenjtë, por edhe Lidhjes Arabe, e cila ka bërë shumë për të ndërmjetësuar, sidomos gjatë luftës në Irak – e pastaj, fusha e dytë, bashkëpunimi kulturor, dialogu i kulturave, dialogu i qytetërimit e edhe dialogu ndërfetar, që mund

të realizohet me Lidhjen Arabe, e cila ka një departament për kulturën. Me Memorandumin e Mirëkuptimit duhet të shohim se ç'mund të bëjmë e ç'kontribut mund të japim së bashku. Sipas jush, për Lidhjen Arabe po bëhen përparësi marrëdhëniet me Selinë e Shenjtë e me Kishën Katolike në përgjithësi? Mendoj se Lidhja Arabe i vlerëson shumë deklaratat e Atit të Shenjtë dhe të personave të tjerë. Ajo mban parasysh edhe gjendjen e të krishterëve në vendet arabe, në interes të paqes e të zhvillimit të rajonit. Në këtë kuptim besoj se mund të shihen marrëdhëniet ndërmjet Selisë së Shenjtë e Lidhjes Arabe, të cilat kanë rëndësinë e vet për Lidhjen.

(Përgatiti: Don Pal Tunaj)

Bazelika e Shën Pjetrit në Vatikan



Shenjtërit apostuj

Kryeapostulli Shën Pjetri

Hyrje

Fjalën Hyjnore, të cilën e ka predikuar Jezu Krishti, është dashur që të vazhdohej edhe tek të tjerët dhe, për këtë arsye, i ka zgjedhur 12 apostujt si dëshmitarë për të predikuar fjalën e tij. Në një anë, Fjala ka pasur nevojën të ketë një person, në anën tjetër personi është dëshmitari i lidhur me fjalën, të cilëve u është besuar fjala, jo pse ai e ka krijuar. Ky qëndrim i ndryshëm – në mes Fjalës Hyjnore, të jetës së Zotit tonë

Jezu Krishtit – dhe personit, i cili e përçon është një gjë qenësore e strukturës së Kishës. Zoti ynë i ka ftuar 12 nxënës apo apostujt për të vazhduar predikimin e fjalës

Hyjnore. Numri i 12-të është i bazuar në 12 fiset e Izraelit dhe pasi që Juda e ka tradhtuar Jezu Krishtin, në vend të tij është zgjedhur Matia. Pas ngjalljes së tij, Jezusi

e zgjodhi edhe shën Palin si apostull të tij, i cili më parë e kishte persekutuar Krishtin dhe Kishën. Këta apostuj kishin për detyrë që ta vazhdonin praninë e Kishës në botë dhe gjeneratat e dyta të tyre u shndërruan në dërgimin ipeshkvor apo "episkopos". Është mirë që të shpjegohet këtu edhe fjala "vescovo" që në shqipe përkthehet peshkop apo ipeshkëv. Kjo fjalë është nga gjuha italiane, e cila është përkthyer nga fjala greke "episkopos". Kjo ka kuptimin për dikë, i cili i mbikëqyr gjërat prej së larti dhe i sheh i me zemër. Kështu shkruan edhe Shën Pjetri për Zotin tonë Jezu Krishtin: "bari dhe rojtë i shpirtit tuaj". (1 Pjet 2,25). Dhe këtë shembëlltë të Zotit, i cili, në rend të parë, është rojtar dhe bari i shpirtave, pasardhësit e apostujve e kanë quajtur "episkopi"



apo ipeshkvij. Atyre u është dhënë detyra e "episkopëve", pra detyra për ruajtjen e shpirtave. Këtë detyrë e kanë ushtruar ipeshkvijtë deri tek shën Injaci i Antiokisë në fillim të shekullit të II, i cili këtë detyrë e shndërroi në tri detyra: Ipeshkëv, meshtar dhe xhakon. Ky zhvillim ndodhi nën udhëheqjen e Shpirtit Shenjt, i cili i dallon pasardhësit e vërtetë të Krishtit prej atyre të gabuarve.

Shën Pjetri

Për ta kuptuar sa më mirë dërgimin e Kishës, ne e shohim se Kisha është e ndërtuar në persona dhe ekziston prej personave dhe kjo kishë u është besuar 12 Apostujve. Ne gjatë këtyre 13 të martave do të flasim për këta 12 Apostuj, në të cilët është ndërtuar kjo Kishë. Ne gjatë këtyre 13 të martave do të flasim për secilin apostull dhe në mënyrë të posaçme do t'i analizojmë njërin pas tjetrit në jetën e tyre dhe do të mundohemi që ta kuptojmë çka do me thënë me qenë Kishë dhe çka do me thënë me shkua pas Krishtit. Sot do të fillojmë me Shën Pjetrin. Pas Jezusit, shën Pjetri është personi më i pranishmi dhe më i njohuri në Besëlidhjen e Re. Ai përmendet 154 herë me emrin "Pëtro", që do me thënë "Guri", apo "Shkëmb". Ky është përkthimi grek i gjuhës arameje "Kefa". Këtë emër ia dha Jezu Krishti dhe i cili tek letrat e shën Palit përmendet nëntë herë. Po ashtu shpeshherë ceket edhe emri »Simon« (75 herë), kjo është forma precize e emrit të tij nga emri hebraisht »Simón« (dy herë: Vap 15,14; 2 Pjt 1,1). Simoni biri i Gjonit (krah. Gjn 1,42) apo forma arameje, »Barjona«, biri i Jonës (krah. Mt 16,17), i cili kishte prejardhjen prej Betsaidës (krah. Gjn 1,44), një qytet i vogël në lindje të liqenit të Galilees, prej nga vijnë edhe Filipi dhe natyrisht vëllai i shën Pjetrit Andreu. Gjuha e tyre ka pasur dialektin e Galileesë. Pjetri, sikurse edhe vëllai i tij, ishte peshkatar, së bashku me familjen e Zebedeut, të atin e Jakobit dhe Gjonit dhe kishin një punë të vogël në liqenin e Gjenezaretit (krah. Lk 5, 10). Nga kjo, këta peshkatarë kishin një gjendje të mirë ekonomike, por ishin edhe fetar dhe për këtë arsye kishin shkruar për ta dëgjuar Shën Gjonin duke predikuar (krah. Gjn 1,35-42).

Pjetri ishte një fetar i madh jude, besonte në praninë e Hyjit në historinë e popullit të tij. Ishte i martuar dhe një ditë Jezusi

e shëroi vjehrrën e tij, e cila jetonte në Kafarnaum, në qytetin ku jetonte edhe Shën Pjetri kur ishte në atë qytet. (krah. Mt 8,14f; Mk 1,29ff; Lk 4,38f.). Ungjilltarët na lajmërojnë se Pjetri ishte njëri prej katër nxënësve të parë të Jezusit nga Nazareti (krah. Lk 5,1-11), dhe atyre iu bashkëngjiti edhe i pesti dhe kështu u plotësua numri tradicional për të qenë Rabin, për të qenë rabin është dashur t'i ketë pesë nxënës (krah. Lk 5,27; Thirrja e Levit). Pastaj Jezusi kaloi prej pesë nxënësve në 12 (krah. Lk 9,1-6), edhe me këtë risia e dërgimit të tij ishte e qartë: Ai nuk ishte një Rabin prej shumë të tjerëve, por kishte ardhur për t'i bashkuar dhe udhëhequr 12 fiset e Izraelit.

Simoni shihet në Ungjill me një karakter impulsiv; ai ishte i gatshëm që dëshminë e tij ta realizojë edhe me dhunë (këtu mendohet në përdorimin e shpatës në kopshtin e ullinjve, krah. Gjn 18,10f.). Dhe në të njëjtën kohë ishte naiv dhe frikacak, por edhe i singërtë deri në pendim të thellë (krah. Mt 26,75). Ungjilltarët e kanë përcjellë në rrugën e tij hap pas hapi. Fillimi ishte tek thirrja përmes Jezusit. Ajo ndodhi në një ditë të rëndomtë, derisa ai kryente punën e rëndomtë si peshkatar. Jezusi gjendej në liqenin e Gjenezaretit, dhe pas tij shkonin një mori e madhe e popullit sepse dëshironin ta dëgjonin. Dhe numri i madh krijonte edhe vështirësi. Mësuesi pa dy anija të cilat gjendeshin në breg të liqenit, peshkatarët kishin zbritur dhe kishin filluar për t'i larë rrjetat. Jezusi e pyeti Simonin a mund të hip në barkën e tij dhe iu lut që ta largon pak prej bregut të liqenit. Ai mori një seli të improvizuar dhe filloi që ta mësion dhe t'i predikoi popullit (krah. Lk 5,1-3). Dhe në këtë mënyrë, barka e shën Pjetrit u bë selia e mësimit të Jezusit, u bë »Katedra« e tij. Pasi që e përfundoi predikimin i tha shën Pjetrit: »Grahni në liqet! Atje gjuani rrjetat tuaja për të zënë peshk!« e Simonin i tha atij: »Mësues, ne kemi punuar tërë natën dhe asgjë nuk kemi zënë. Por nëse ti thua, do t'i gjuaj rrjetat.« (Lk 5,4-5). Jezusi me profesion ishte një zdrukthëtar dhe nuk kishte lidhje me zënie të peshqve: prapëseprapë peshkatari Pjetri i besoi këtij mësuesi, i cili nuk i dha kurrfarë përgjigje, por e thirri që të besojë. Reagimi i tij pas zënies së shumë peshqve ngjalli befasi dhe frikë: »O Zot, largohu prej meje sepse unë jam mëkatar!« (Lk 5,8). Jezusi iu përgjigj atij duke i kërkuar besim dhe duke ia hapur një plan, i cili do t'i tejkalojë të gjitha perspektivat: »Mos u frikoni! Prej tani do të zësh njerëz.« (Lk 5,10). Pjetri nuk mundte ta paramendojë se një ditë do të shkojë deri në



Romë, se do të jetë »Peshkatar njerëzish« për zotërinë. Ai e pranoi këtë thirrje dhe lejoi që të hynte në këtë detyrë: ai është guximtar, edhe pse ishte i kufizuar, por ai besoi në të që e thirri dhe e ndjek ëndrrën e zemrës së vet. Ai tha po – një po e guximshme dhe zemëruese – dhe u bë nxënës i Jezusit.

Një përjetim tjetër të rëndësishëm të rrugës së tij e përjetoi në afërsi të Cezaresë së Filipit, kur Jezusi iu drejtua nxënësve të tij me pyetje: »Çka mendojnë njerëzit për mua?« (Mt 8,27). Jezusit nuk i interesonte shumë mendimi i atyre që e dëgjonin, ai ishte më tepër i interesuar për mendimin e tyre që mendojnë dhe për atë arsye ai i pyeti përsëri: »Por ju, çka mendoni kush jam unë?« (Mt 8,29). Pjetri ishte ai, i cili iu përgjigj për të gjithë: »Ti je Krishti, ti je Mesia (krah. ebd.). Kjo përgjigje e Pjetrit, e cila nuk ishte një përgjigje e »mishit dhe gjakut«, por ishte një dhuratë nga Hyji (krah. Mt 16,17), bart në vete kuptimin e besimit të Kishës. Deri atëherë Pjetri nuk e kishte kuptuar thellësinë e dërgimit mesianik, kuptimin e ri të fjalës »Mesia«. Këtë e tregon pak më vonë, kur Jezusi flet për mundimin e tij dhe ai proteston, ndërsa Jezusi reagon në mënyrë energjike kundër tij (krah. Mk 8,32-33). Pjetri dëshiron një Mesia, në të cilin është »njeriu hyjnor«, i cili i plotëson premtimet e popullit dhe i cili e përdor fuqinë e tij për ta: Kjo është edhe dëshira jonë, që Zoti ta përdorë fuqinë e tij dhe që ta ndryshojë botën. Jezusi paraqitet sikurse »njeri hyjnor«, si shërbëtor i Hyjit, i cili i dridh

shumë prej shpresave tona, kur pranon rrugën e kryqit dhe të vuajtjes. Kjo vendosje duhet të jetë edhe për në një alternativë, me të cilën duhet përhërë të mësojmë. Pjetri – impulsiv, siç është – nuk frikohet për ta marrë Jezusin dhe për ta kundërshtuar.

Përgjigja e Jezusit i thyen shpresat e tij të gabuara dhe e thërrret në pendim: »largohu prej meje he djall! Sepse nuk e ke në mendje atë çka dëshiron Hyji, por çka dëshirojnë njerëzit.« (Mt 8,33). Ti nuk mund që të m'i paracaktosh rrugët, por duhet të vijsh pas meje. Kështu e mëson Pjetrin, çka do me thënë me të vërtetë me ecë pas Krishtit. Ky është profesioni i tij i dytë, siç ishte edhe ai i Abrahamit në Zanafilla 22, e cila rrjedh nga Zanafilla 12: »Nëse ndokush do të vijë pas meje, le t'i bjerë mohit vetvetes, ta marrë kryqin e vet e të më ndjekë. Sepse, ai që do ta shpëtojë jetën e vet, do ta bjerrë, përkundrazi, ai që do ta bjerrë jetën e vet për mua e për Ungjill, do ta shpëtojë.« (Mt 8,34-35). Ky është ligji i atyre që shkojnë pas Krishtit: Duhet mohuar nëse është e nevojshme edhe gjithë botën për t'i shpëtuar vlerat e vërteta, për të shpëtuar shpirtin, për ta shpëtuar praninë e Hyjit në botë (krah. Mk 8,36-37). Pjetri pranon thirrjen e Jezusit dhe ec nëpër gjurmët e mësuesit të tij.

(Të dashur lexues të "Dritës", në këtë rubrikë do të kemi mundësinë për të përcjellë jetën dhe veprën e 12 apostujve. Këto shkrime janë të nxjerra nga faja e internetit www.misioni.ch, të përgatitur nga don Marjan Marku)

Nderimi ndaj Zojës së Bekuar dhe Shenjtërve

Maria, plotë mirësi, është gëzimi i Zotit, ajo e madhëruar mbi të gjithë engjëjt dhe Shenjtërit, jetoi një jetë krejt të rëndomtë. Maria është një krijesë si ne, me një zemër si e jona, e krijuar për gëzim dhe buzëqeshje aq sa edhe për vuajtje dhe lot. Para se Engjëlli Gabriel t'ia dëftojë planet e Zotit, Virgjëra nuk e dinte se ishte e përzgjedhura prej të Amsbueshmit për të qenë Nëna e Mesisë. Për këtë ajo mund të pohojë se Ai i cili është i plotfuqishëm bëri për të punë të mëdha.

Përgatiti:
Don Agim QERKINI

Maji – Muaji i Zojës Bekuar

Sikur Kisha e gjithmbarshme, ashtu edhe Kisha jonë lokale, ka zhvilluar një devotshmëri të veçantë ndaj Zojës. Muaji maj që është i kushtuar Zojës së Bekuar, është muaji më i bukur i vitit. Në kontekstin natyror shpreh zgjimin dhe gjallërinë e saj duke marrë një pamje të re, ndërsa në kontekstin shpirtëror, ky muaj posaçërisht është i pasur me devocionë kushtuar Zojës së Bekuar.

Roli i Saj si ndërmjetësë për të mirën shpirtërore dhe trupore të njerëzve, është i pakontestueshëm, si gjatë historisë së mbarë njerëzimit, ashtu edhe në përvojën tonë si shqiptarë. Mjafton të përmendim faktin e Zojës së Shkodrës, Pajtores shqiptare, e cila ka dëshmuar një kujdes të veçantë ndaj nesh si popull, me qëllim që të shpëtohen vlerat e krishtera në popullin tonë.

Në ipeshkvinë tonë, veçohet shenjtërorja e Zojës në Letnicë, vend ky i cili me plotë të drejtë mund të quhet si qendër eku-menike, vend bashkimi i besimtarëve të besimeve të ndryshme. Muaji i majit, e posaçërisht gushti i japin një gjallëri të madhe kësaj shenjtëroreje. Këtu gjatë festave të Zojës, e posaçërisht me rastin e festës së “Zojës Çernagore”, bashkohen në lutje përpos katolikëve, edhe besimtarë ortodoksë e myslimanë, të gjithë me të njëjtën dëshirë, të kërkojnë hira dhe ndihmën e Zojës.

Përgjithësisht, nderimi ndaj Zojës së Bekuar karakterizohet me devocionë të shumta dhe ndër to veçohet lutja e rruazares në familje, pastaj litanitë e Zojës që kurorëzohen me adhurim para të Shenjtërueshmit Sakrament etj.

Si individ, apo edhe si Kishë, nuk duhet të jemi të kënaqur krejtësisht me organizimet që bëhen gjatë muajit maj, sepse sigurisht mund të bëhet më tepër, goftë me grupet e lutjes në bashkësitë e caktuara, apo edhe në forma tjera.

Këto takime në uratë, pady-

shim e forcojnë bashkësinë që ta përfetojë praninë e Zotit në mesin e vet.

Në këto gjëra na thërret Zoja e Bekuar, e cila dëshirë të vetmen ka që njerëzit t'i drejtojnë kah Biri i saj Jezu Krishti. Ajo dëshiron të na shoh sa më afër Birit të vet në mënyrë që Kisha, Nënë e së cilës është vetë Zoja, të rritet vazhdimisht në fe.

Ne, duhet të jemi të sigurt se, Zojës më tepër i intereson që t'i përngajmë asaj me jetën tonë se sa të flitet për të. Për këtë arsye, duhet të angazhohemi të përhelohemi në uratë, duke medituar jetën dhe mënyrën e saj të qëndrës në uratë.

Kisha e Krishtit jemi në të gjithë, prandaj duke e pasur Zojën si një avokate, ndërmjetësë para Birit të vet Jezu Krishtit, le të mundohemi ti përngajmë asaj me një jetë të denjë. Ta luftojmë mëkatën, e në anën tjetër le të na bashkojë emri i Zojës bekuar e cila ka për zemër të gjithë ata që e lusin me devotshmëri. T'i lutemi Virgjërës Mari të na bëjë meditues dhe të na mësojë t'i ndiejmë thirrjet e vazhdueshme të Zotit. Le ta lusim tani: Nëna jonë e dashur, ti e solle në jetë Jezusin i cili na e zbuloi dashurinë e Atit-Zotit tonë. Na ndihmo ta njohim kujdesin e tij ndaj nesh në përditshmërinë tonë. Nxite mendjen dhe vullnetin tonë në mënyrë që të mund ta dëgjojmë zërin Tij.

Nderimi ndaj Zojës së Bekuar

Misioni i Zojës së Bekuar në veprën e shëlbimit tonë është i asaj natyre saqë, e vetmja prej njerëzve e meriton të quhet bashkëshëlbuese e jona. Në Besëlidhjen e Re e shohim atë jo vetëm në momentet e lindjes dhe vdekjes, varrimit dhe ngjalljes së Jezu Krishtit, apo edhe në raste tjera, por edhe në bashkimin e Kishës së parë në uratë: “*Të gjithë këta ishin të përgjendruar prare së bashku në uratë me disa gra, me Marinë, Nënë e Jezusit, dhe me vëllezërit e tij*” (Vap 1,14).

Kur autorë të ndryshëm thonë se deri në Koncilin e Efëzës (431) nuk ka pasur ndonjë nderim

“ Me plotë të drejtë papët e shumë e quajnë Marinë si bashkëshëlbuese të Krishtit për shëlbimin e njerëzimit. Ajo iu bashkua Birit të vet në vuajtje plotësisht për të mirën e gjithë njerëzve. Ajo hoqi dorë nga e drejta e një nëne mbi të Birin e saj dhe e sakrifkoi atë për të plotësuar drejtësinë e Zotit. Pra, ajo bashkë me Krishtin e shëlboi njerëzimin. Kjo na jep neve një kuptim më të thellë të atij momenti të Mundimeve të Zotit për të cilin kurrë nuk duhet pushuar së medituari, se: *Stabat autum iuxta crucem Jesu mater eius -Pranë Kryqit të Jezusit ishte edhe nëna e tij.* ”



liturgjik ndaj Zojës Bekuar, mendohet në aso nderimi çfarë e ka Kisha sot e që është zhvilluar gjatë historisë. Fjala është për festat e Zojës, kishat që i janë kushtuar, shenjtëroret, definicionet solemne të dogmave për Zojën etj. Më vonë, fillojnë të paraqiten kisha kushtuar Zojës Bekuar.

Se sa ishte përhapur kjo dukuri na dëshmojnë edhe tekstet e Shën Çirillit të Aleksandrisë (+ 444): “*Të falem, o Nëna e Zotit! Besimtarët e drejtë i kushtojnë kisha emrit tënd në qytete, fshatra e ujdhësë*”.

Në anën tjetër, qysh në katakombet e Romës të shek. II dhe III hasim në ikona të cilat paraqesin Zojën e Bekuar. Për më tepër, lindja dhe zhvillimi i ciklit liturgjik të krishtlindjeve nga shekulli i IV do të na jep mundësi të reja për zhvillimin më të hovshëm të nderimit dhe të kultit marian.

Sidomos me Koncilin e Efëzës, do të fillojë të diskutohet mbi personalitetin e Zojës, si dhe do të shtohen mundësitë e një zhvillimi më të madh të trajtimit të saj, pra, pas definimit të dogmave se Zoja e Bekuar është Nëna e Hyjtit, *Theotokos - Hyjlindëse*.

Kisha më e vjetër kushtuar Zojës Bekuar në Romë është ajo në vendin e kishës së sotme *S. Maria trans Tiberim*, Zoja e Madhe - S. Maria Maggiore.

Është me rëndësi të thuhet se me ndërtimin dhe kushtimin e kishave Zojës së Bekuar do të shtohet gjithnjë e më tepër edhe nderimi ndaj ikonave të saja.

Për këtë art - thesar të Kishës, më tepër ishte e njohur bota lindore se sa ajo perëndimore. Ikona e parë e Zojës e njohur quhet *"odegitria"*, të cilës, sipas traditës mbretëresha Eudoksia prej Jeruzalemi ia dërgon kushërirës se vet Pulherisë. I përshkruhej Shën Lukës. Në Lindje edhe një tjetër i përshkruhej Shën Bartolomësë (Armeni).

Në botën Perëndimore kjo formë e artit po ashtu do të filloj të merr një hov zhvillimi, por më tepër që nga shekulli i IV.

Kështu, çdo kulturë do ta paraqes në mënyrën e vet: Arti bizantin e paraqet si mbretëreshë pranë Krishtit, Mbretit të botës; Renesanca e paraqet në pastërtinë e bukurisë klasike; Baroku si gruan e veshur me diell, ngadhënjyese mbi djallin dhe periudha moderne si bashkëpunëtore në veprën e shëlbimit.

Festa e parë e Zojës Bekuar është e njohur që nga shekulli i V. Dëshmi janë himnet e një shkrimtari sirian Balaja, por edhe fjalimi i famshëm i Prokulit të Carigradit i vitit 429. Bëhet fjalë për të kremen e Zojës së Bekuar në të cilën kremtohet me theks të veçantë virgjëria e saj. Kjo ditë kremtohej pas Krishtlindjes, më 26 dhe 27 dhjetor.

Shumë prej lutjeve kushtuar Zojës Bekuar, bazë të përmbajtjes i kanë tekstet burimore të Shkrimit Shenjt. Kështu sa për ilustrim lutja të "Falem Mari" të cilën e lusim në formën e sotme e hasim të Luka Ungjilltar (Lk, 1, 28); pastaj rrugarja e Zojës si formë jo liturgjike e lutjes së "Të falemi Mari" i përshkruhet shën Dominikut; Lutja "Engjëlli Tenzot" për herë të parë përmendet në një kuvend francezkan në Pizë më 1236, ndërsa "Mbretëreshë e Qiejllës" që e lusim në kohën e Pashkëve ka hyrë në shekullin e XVIII dhe e porositi papa Benedikti XIV.

Të kremen dhe festat e Zojës gjatë vitit

Kalendari Romak i Reformuar për mbarë Kishën Katolike përmban këto festa të Zojës së Bekuar:

Tri të kremen: Maria-Nëna e Hyjit (1 janar); Të Ngriturit në qiell (15 gusht); Të Zënës e pa mëkat të Zojës (8 dhjetor).

Dy festa: Vizita e Zojës Bekuar (31 maj); Lindja e Zojës së Bekuar (8 shtator).

Katër përkujtime të obligueshme: Festa e Zojës Virgjëreshë Mari Mbretëresha qiejllit e dheut (22 gusht); Zoja e dhimbshme (15 shtator); Zoja Rruzare (7 tetor); Paraqitja apo kushtimi i Zojës në tempull (21 nëntor).

Katër përkujtime jo të obligueshme të Zojës janë: Zoja e Lurdit (11 shkurt); Zemra e Zojës (e shtuna pas festes së Zemrës Krishtit); Zoja e Karmelit (16 korrik); Shugurimi i bazilikës së Zojës (5 gusht).

Pra, në këtë cikël vjetor të mistereve të Krishtit, Kisha në mënyrë të veçantë e nderon Marinë, të shenjtueshmën Nënë e Hyjit, e lidhur në pandashmëri me veprën e shëlbimit të Birit të vet: në Marinë madhërohet dhe lartësohet fryti më i përsosur i shëlbimit" (SC 103).

Çfarë do të bënim ne po të kishim mundësinë ta zgjidhnim nënën tonë? Jam i sigurt se do ta zgjidhnim Zojën e Bekuar, duke e adhruar me çdo nderim të mundshëm. Këtë gjë e bëri Krishti. Kjo është arsyeja me e madhe pse Zoti ynë ia dhuroi nënës se tij të gjitha privilegjet e mundshme që nga momenti i ngjizjes se saj të Papërlyer. Ajo ishte e liruar nga fuqia e djallit. Ajo është krejt e bukur, pa njollë mëkati dhe krejt e pastër në shpirt e në trup.

Nderimi i Shenjtërve

Gjatë vitit liturgjik kishtar, Kisha përkujton shenjtërit dhe martirët e fesë të cilët kanë bërë një jetë të shenjt apo kanë dëshmuar besimin në Krishtin duke e dhënë jetën e vet për të. Në këtë cikël vjetor Kisha e ka futur përkujtimin e martirëve dhe shenjtërve që hiri i shumëllojshëm hyjnor i ka lartësuar deri në përsosmëri, kështu që ata e kanë fituar shpëtimin e përrjetshëm dhe në qiell i këndojnë lavde Hyjit dhe ndërmjetësojnë për ne. Në ditë-lindjen e tyre Kisha e shpall misterin e pashkëve në shenjtërit, të cilët me Krishtin kanë bashkë vuajtur dhe me të janë bashkë lavdëruar (SC104).

Jemi në kohën e gëzueshme të Pashkëve dhe mësimi i Shën Palit, të cilit këtë vit Kisha po ia feston 2000 vjetorin e lindjes, përqendrohet pikërisht në ngjalljen e Jezu Krishtit si qendra e mbarë historisë, sepse në të plotësohen ligji dhe profetët, dhe nga Ai vjen shëlbimi për të gjithë.

Në historinë që ndërlidhet me nderimin shenjtërve shohim se hebraizmi i kohës së Krishtit e ka njohur nderimin e varreve të shenjtërve.

Edhe kulti i krishterë ndaj martirëve rrjedh prej nderimit familjar të vdekurve e që zhvillohej rreth varreve. Ky kult përbëhej prej dy formave:

- *Rifrigerium*, gostia mortore si shprehje e jetës se të vdekurit, apo e bashkësisë se të vdekurit me të tjerët edhe pas vdekjes;
- *Dies natalis*, përkujtimi i lindjes se të vdekurit që e përcillin paraqitja e flujimeve ndaj hyjnive të nëntokës.

Të krishterët i kanë pranuar ato forma të nderimit, por gjith-



sesi me ndryshime të cilat dalin nga besimi në ringjallje dhe jetën e pasosur.

-Varrosja në tokë sipas shembullit të Krishtit duke pritur ngjalljen, për dallim nga dëgjia; - Dies natalis është dita e vdekjes e jo e lindjes. Me këtë vdekje e martirëve është shpallur si fitore dhe hyrje në lavdinë e Zotit.

Që nga mesi i shekullit të II hasim në shenjat e nderimit të martirëve të Krishtit - *Martyres*. Këtë emër e fitonin ata të cilët me vdekje e dëshmonin Jezu Krishtin, duke i përngjarë më për së afërmi atij. Në Lindje rasti më i vjetër i nderimit të martirëve është rasti i Shën Polikarpit të Smirnes rreth vitit 165.

Ndërsa në Romë martirët më të vjetër të nderuar janë Shën Kalisti Pape 222, Siksti II Pape, dhe 7 xhakonëve të tij viti 258; pastaj Shën Çipriani në vitin 258 etj.

Në çka qëndron nderimi ndaj shenjtërve?

- E gjithë bashkësia e të krishterëve bashkohet si një familje rreth varreve të martirëve, kështu kremen *refrigerium*, lutjet dhe Eukaristinë;
- Edhe pas përndjekjeve të ndryshme për shkak të be-

simi, si martirë janë nderuar ata pësonin përndjekje për shkak të Emrit të Krishtit - *confessores*;

c) Me lirinë fetare, atëherë kur persekutimi i Kishës bie, dëshmimi heroik i fesë do të merr një kahe tjetër, mbi të gjitha me format e dëshmimeve të njerëzve asket;

d) Shpejt u janë bashkangjitur asketeve edhe virgjërat e kushtuara Zotit. Jeta e tyre është një mënyrë e lartë e jetës asketike, prandaj e meriton nderimin për shkak të dëshmimit heroik. Atëherë tyre me pastrë dhe detyra në Kishë nderim të veçantë kane merituar edhe të vejat.

e) Shume ipeshkvij të kishës se parë ishin martirë: Injaci i Antiokisë, Polikarpi i Smirnes, Pjetri i Aleksandrisë, Potini Lionit, Poncijani, Fabijani, Korneli, Siksti i Romës etj. Ipeshkvi i pare që nuk ishte martirë por që nderohej si shenjt ishte Gregori Mrekullibërës rreth vitit 270.

Nderimi i martirëve prej fillimit është dalluar me nderimin ndaj të vdekurve në përgjithësi, sepse nga ana e Kishës ende nuk kishte ndonjë karakter apo formë zyrtare të nderimit të tyre.

Por, "kanonizim" siç është forma procedurale sot nuk kishte. Gregori i Madh sjell faktet se çka kërkohej nga ana e Kishës lidhur me shënimet për personin në mënyrë që ta radhisë një martir në listën e përkujtimeve. Ajo që kërkohej ishte: *Nomen, locus, dies* - Të dihet emri, vendi dhe dita e dëshmimit të fesë.

Sipas traditës, në Kishë nderohen shenjtërit, por lidhur me këtë, duhet nderuar edhe reliket e tyre si dhe figurat që i paraqesin ata. Të kremen e shenjtërve na shpallin se si Krishti është i mrekullueshëm në shenjtërit e vet, kurse besimtarëve iu dhurohen shembuj të shkëlqyeshëm ndjekjeje (SC 11).

"Gjaku i martirëve, fara e të krishterëve" shkruan Tertuliani, dhe janë të shumtë shenjtërit të cilët kanë lënë shembull të mirë të qëndrës në virtyte, duke mohuar jetën e vet, për ta rifituar atë në Krishtin. Devocioni edhe ndaj shenjtërve na forcon në jetën tonë të krishterë, prandaj, edhe sipas mësimëve dhe dëshmimeve të tyre jeta e secilit të krishterë duhet ta ketë për model ligjin e dashurisë ndaj Zotit dhe ndaj të afërmit.

E diela e Bariut të Mirë – dita e lutjes për thirrjet meshtarake dhe të jetës së kushtuar

Takimi me familjet e meshtarëve, rregulltarëve dhe rregulltareve në Zllakuqan

SHKRUAN:
m. Teuta AUGUSTINI

Në të dielën e katërt të Pashkëve, të quajtur edhe e Diela e Bariut të mirë, Kisha katolike kremton Ditën Botërore të lutjes për thirrjet meshtarake dhe të jetës së kushtuar.

Hyji e do çdo njeri, të cilin vetë e krijon. Me pagëzim njerëzve ua mundëson të bëhen bijtë e tij brenda Trupit mistik të Krishtit të ringjallur. Ajo çka kërkon prej të gjithë fëmijëve të tij, është dashuria dhe besnikëria ndaj tij, bindja urdhërimeve që çon në jetë të lumtur. Ta duash Hyjin dhe njerëzit është thelbi i jetës, që simbolikisht shprehet në shenjë e kryqit, bashkim i vertikales dhe horizontales, dimensionit hyjnor e njerëzor. Të gjithë jemi të ftuar në këtë mënyrë ta arrijmë shenjtërinë. Por Hyji brenda kësaj thirrjeje të gjithëmbarshe në shenjtëri, zgjedh disa persona që ta ndjekin Jezusin më nga afër. I fton që të shërbejnë në shtëpinë e Zotit dhe të jenë dëshmitarët e tij të palodhshëm. Nisma është gjithmonë e Hyjit, por ai e kërkon përgjigjen e lirë të zemrës së njeriut. Ai thërret njerëz të moshave, kombësive e kulturave të ndryshme që janë të gatshëm t'ia dhurojnë jetën në tërësi dhe ta vënë në shërbim të Ungjillit dhe përsheptimit të ardhjes së Mbretërisë së Hyjit.

Jezusi apostujve u ka thënë që duhet ta lusin Atin që të dërgojë korrarë në të korrat e veta, punëtorë që nuk kursehen. Është shumë e rëndësishme lutja e përvujtë e drejtuar Hyjit nga ana e besimtarëve, familjeve, mbarë famullisë që Ati të dërgojë njerëz të rinj, të cilët do të bashkëpunojnë me Zotin në veprën e Shëlbimit si meshtarë dhe rregulltarë. Për personin, i cili do ta ndjekë rrugën e Zotit, është me rëndësi ambienti dhe feja ku ai rritet. Përjetimi i dashurisë së Hyjit që e bart prindi tek

fëmija ka rol vendimtar në jetën e një shpirti të ri i cili ndjen në zemër të vet thirrjen që ia drejton Jezusi për ta ndjekur. Feja e gjallë në bashkësinë famullitare, jeta sakramentale dhe kujdesi e lutja për thirrjet në famulli japin frytë të begatshme në favor të zgjimit të thirrjeve të reja.

Të zgjedhur dhe të ftuar nga Zoti, merren nga populli për t'i kthyer sërish në popull plot me Zotin. Të prekur nga dashuria e Krishtit ata zbulojnë gjurmët e përjetësisë që në këtë jetë dhe e dëshmojnë këtë dashuri të Hyjit, duan të jetojnë me Të dhe për Të.

Ata që Zoti i zgjedh për meshtarë, i shuguron me sakramentin e Urdhrit shenjt të meshtarisë, i cili në ta vendos vullën e shenjtë të pushtetit të Tij hyjnor për t'i shenjtëruar njerëzit, për t'i mësuar e drejtuar.

Pra, mister i Shpëtimit u besohet në duar njerëzve, duke filluar prej Papës, zëvendësit të shën Pjetrit kryeapostull, ipeshkvijve, meshtarëve e xhakonëve, që kanë shkallë të ndryshme të të njëjtit sakrament, me të njëjtën vazhdimësi, e cila ka filluar nga Jezu Krishti i cili i ka shuguruar dymbëdhjetë apostujt e vet.

Jeta e kushtuar dallon nga thirrja meshtarake, nga që rregulltarët apo të kushtuarit përkushtohen e nuk shugurohen. Tri kushtet ungjillore që ata i bëjnë: pastërtia - virgëria, varfëria dhe dëgjesa, janë mënyrë e jetës sipas jetës së Jezusit në tri dimensionet e jetës tokësore të tij në raport me Atin dhe me njerëzit. Ata e ndjekin Krishtin duke jetuar në një bashkësi - Institut rregulltar ose Kongregatë të jetës apostolike. I kushtohen shërbimit të Hyjit duke u lutur, duke e jetuar Ungjillin me përpikëri dhe duke e shndërruar dashurinë që e marrin nga Zoti në vepër dashurie për njerëzimin. Me kushtin e dëgjësës besojnë se duke iu bindur eporit e dëgjojnë vetë Zotin, në pastërti shpirtërore e fizike jetojnë duke mos krijuar familje e duke ia




Mons. Dode Gjergji gjatë Meshës në Zllakuqan





Don Izak Dodë, famullitar në Zllakuçan



dhuruar Hyjit zemrën në tërësi si dhe në varfëri të plotë, pa asnjë pronë private dhe pa të holla, duke u mundur t'i përngjajë Jezusit i cili, i dëgjueshëm krejtësisht ndaj Atit, nuk kishte as vend ku ta mbështeste kokën, por e flijonte jetën për njerëz duke u bërë mirë e duke mësuar nga vendi në vend.

Rregulltarët meshkuj mund edhe të shugurohen meshtarë dhe në të njëjtin person të jetojnë edhe kushtimin edhe shugurimin e tyre për të qenë krejtësisht të Zotit dhe në shërbim të tij e të njerëzve.

Përveç priftërinjve dioqezanë, në Kosovë aktualisht veprojnë njëmbëdhjetë Kongregata të ndryshme të Jetës së kushtuar, nga ato, tetë femërore dhe tri mashkullore: Motrat Baziliane, Bijat e Dashurisë Hyjnore, Bijat e Dashurisë së Krishterë – Vinçencianet, Motrat Françeskane të Zojës së Papërluyer, Misionaret e Bamirësisë, Motrat Engjëllore të shën Palit, Motrat e shën Filip Nerit, Motrat e Mëshirshme të shën Kryqit, Vëllezërit Françeskan, Salezianët dhe Jezuitët.

Tashmë është bërë traditë që në kohën e Pashkëve të mbledhen priftërinjtë dhe motrat nga mbarë Kosova për të kremtuar e bashkëndarë gëzimin e ngjalljes së Krishtit dhe për ta forcuar njëri-tjetrin në fe. Ky është qu-

ajtur shtegtimi i Emausit, sipas ngjarjes biblike ku dy nxënësit e takojnë udhës Jezusin e ringjallur duke shkuar të dëshpëruar për në fshatin Emaus dhe e njohin vetëm në çastin e thyerjes së bukës dhe të mahnitur kthehen në Jeruzalem plot gëzim duke u dëshmuar apostujve se e kanë takuar Jezusin e ringjallur që ishte zhdukur para syve të tyre.

Një takim i tillë u mbajt në Zym, më pas në Bishtazhin, ku ipeshkvi i Kosovës, mons. Dodë Gjergji, për herë të parë i ftoi edhe familjarët e të gjithë priftërinjve e motrave për të festuar së bashku dhe për t'u njohur mes vete. Edhe këtë vit Ipeshkvi u drejtoi të njëjtën ftesë të gjithëve për t'u takuar në famullinë e Zllakuçanit. Në Meshën e kremtuar nga Mons. Doda në bashkëmshim me priftërinjtë, ai ndër të tjera theksoi nismën e Hyjit dhe preferencën e tij për disa zemra që do ta qojnë Lajmin e tij të gëzueshëm deri në skaj të botës. Pas Meshës, në oborrin e kishës, ishte shtruar dreka nga Famullia me pjesëmarrje të familjarëve si dhe një program me këngë dhe valle popullore.

Le t'ia drejtojmë të gjithë së bashku Hyjit Atë lutjen e përzemërt, që edhe këtë vit të na dërgojë vajza e djem zemërgjerë që do të nisen pas Krishtit në thirrjen meshtarake e rregulltare.



Familjarët e meshtarëve dhe motrave gjatë Emausit në Zllakuçan





Intervistë me arkeologjen, shkrimtaren, poeten, zonjën Edi Shukriu

Sot më shumë se kurrë është e nevojshme t'i afrohem i të vërtetës historike

Drita: Zonja Shukriu, ju jeni arkeologja e parë në Kosovë. A mund të na thoni diçka rreth lidhshmërisë suaj me Atë Shtjefën Gjeçovin?

Me Atë Shtjefën Gjeçovin fitova një lidhshmëri emocionale që nga fëmijëria, në kohën kur dëgjoja rrëfimet e gjyshes sime Maria për të. Kështu e di se gjyshi im, Kelë Mjeda, ishte njeriu i fundit që At Shtjefni e takoi në dalje të Prizrenit, në ditën kur u vra në rrugë e sipër për në Zym. Këtë ngjarje e kam përjetësuar në dramën *Lkeni i Hasit*, përmes së cilës jam përpjekur që ta ndriçoj figurën poliedrike të At Shtjefën Gjeçovit, duke e parë edhe si personifikim i fatit të popullit shqiptar, në veçanti të një intelektualit me vizion të veçantë për përpërimin e kombit. Këtë vizion e dëshmoi kur e nisi formën e shkruar të së drejtës zakonore shqiptare, Kanuni i Lek Dukagjinit, me të cilin ka dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm jo vetëm për kombin shqiptar.

Afrinë tjetër dhe njohuri më të shumta për At Shtjefën Gjeçovin kam fituar edhe nga babai im Muhamedi, kur në vitet e 70-ta të shekullit XX dhe më tej u përkujdes në mënyrë institucionale për përjetësimin e veprës dhe të gjurmëve të këtij kolosi kombëtar në Zym dhe në Has në përgjithësi.

Që ta njoh edhe më shumë veprimtarinë e At Gjeçovit tuj, më ka ndihmuar shumë puna voluminoze e poetit të shkëlqyer Fahredin Gunga, i cili përmes *Rilindjes* botoi vëllimet e librave të veprimtarisë së tij.

Arkeologjia është pika tjetër që më lidh me të. Gjeçovi, pa dyshim, ofroi kontribut të çmu-eshëm për nismën e arkeologjisë shqiptare, në kohën kur nisi të zhvillohej arkeologjia nacionale evropiane. Mendoj se Janjeva dhe rrethina e saj, përplot me pasuri arkeologjike, kanë qenë frymëzimi i parë i At Gjeçovit, në veçanti Kalaja e Veletinit. Andaj dhe jo rastësisht kam bërë hulumtime arkeologjike në vitin

1988, me studentët e Universitetit të Prishtinës, me ç'rast janë zbuluar shtresa kulturore që nga epoka e eneolitit deri në mesjetë. Mendoj se aty duhet parë dhe Justinopolin, qytetin aq të kërkuar nga shkencëtarë të ndryshëm, të cilët e ende e shohin thua se është pranë mureve të Ulpianës/Justiniana Secunda.

Për At Gjeçovin do të mund të flisja shumë më gjatë, por me këtë rast dua të theksoj se ishte inspirim i shumëfishtë për mua, në veçanti për aspektin kombëtar, atë arkeologjik, si dhe për shkrimin e nevojës për qasje hulumtuese shumë disiplinare ndaj së kaluarës, gjë që dëshmohej gjithnjë e më shumë.

Drita: Çka do të thotë të jesh në Kosovë nënë, arkeologe, shkencëtare, poete, politike?

Punë e vazhdueshme dhe kënaqësinë që ajo ofron, qoftë edhe për rezultate simbolike. Më duhet të them se puna nuk më lodh, tej lodhin rrjedhat negative që kanë marrë udhë në Kosovën e pasluftës, mungesa e respektimit të ligjit, duke u nisur nga ata që janë të thirrur

për këtë, përvetësimi i pronës intelektuale dhe shkelja e të drejtave të autorit, mos përkrahja e hulumtimeve shkencore, abuzimet me arkeologjinë... Të je të absurditeti më i madh, nuk ka adresë për t'u drejtuar apo, të jam më e saktë, adresa ekziston, por nuk funksionon si duhet.

Drita: Çka na flet akoma nëntoka kosovare, çka mbetet akoma për t'u gjurmuar dhe që është në interesin e shoqërisë dhe të kulturës sonë kombëtare-shqiptare.

Nëntoka e Kosovës ka mundësi të ofrojë shumë më shumë, duke pasur parasysh gjetjet e deritanishme dhe si paralajmërojnë dhe si janë gjetjet e reja të rëndësishme, si pikturimi shkëmbor parahistorik nga Vlashnja, labyrinti rrethor i çarkut të mbyllur i monumentit epigrafik përkushtuar Hyjneshës Dardane nga Smira apo Monumenti mortor nga Dardana/Kamenica. Por, për të mos pritur gjetje të tilla të rastit, duhet bërë përnjohje të hollësishme institucionale arkeologjike të gjithë territorit të Kosovës.

Është e njohur se në Kosovë, të

zhveshur nga mitet dhe mitizimi i saj, banorët më të hershëm ishin dardanët, njeri nga fiset më të mëdha ilire. Përkundër rezultateve të deritanishme, ka nevojë për thellimin e studimeve. Historia e hershme mund të zbardhet kryesisht duke u mbështetur në hulumtimet arkeologjike, por edhe qasjes shumë dimensionale të dhënave që i ofron arkeologjia. Në këtë drejtim duhet nisur studimet në fushën e antropologjisë kulturore dhe të antropologjisë fizike bashkë, studime më se të nevojshme dhe që mungojnë te ne. Madje mungojnë antropologë fizikë, që do të mund të shërbenin edhe për nevojat e sotme lidhur me personat e zhdukur gjatë luftës në Kosovë. Këto kanë qenë arsyt që vitin e kaluar i kam propozuar Universitetit të Prishtinës hapjen e degës së antropologjisë. Në të do të sublimoheshin rezultatet e shkencave të ndryshme dhe në të cilin studimi i antropologjisë fizike, arkeologjisë, etnologjisë dhe historisë së artit do të kishin prioritet.

Ndonëse parimi historik për përcaktimin e së drejtës për subjektivitet që moti është

bërë anakronik, mitizimi i vazhdueshëm i Kosovës dhe propaganda për të drejtën për të e shtrojnë edhe sot nevojën që t'i afrohem sa më shumë të vërtetës historike. Kjo bëhet imperativ edhe nga përvoja e deritanishme kombëtare, pra studimi i historisë prej së cilës duhet mësuar mësim, për ndryshe nuk do të kishte nevojë fare ta mësohej historia.

Drita: Ulpiana dhe bazilikat antike në trevat ilire-dardane, mos janë lënë anash dhe në këtë mënyrë po lihen dhe po dëmtohen gjurmët kristiane?

Qëndron fakti se kishat antike, madje as të gjitha kishat mesjetare të Kosovës nuk janë hulumtuar sa duhet dhe se ende nuk kemi ekspert të specializuar për këtë fushë, si nuk kemi as për xehetarinë antike, që ka qenë bazë për zhvillimin ekonomik që nga koha e metaleve. Madje as që janë evidentuar të gjitha kishat në mënyrë institucionale, ndonëse këto kanë ekzistuar në të gjitha vendbanimet dhe rreth tyre dhe se toponime të shumta anë e mbanë Kosovës *Livadhet e kishës, Lisi i kishës, Varret e kishës*



etj./ dëshmojnë për ekzistimin e tyre. Besoj se studenti im, z. Arben Arifi, i cili ka nisur doktoraturën në Universitetin e Sorbonës në Francë, do të jetë një ndër ekspertët e parë për studimin e kishave antike dhe mesjetare në Kosovë.

Mjerisht, me direktiva dhe me presione politike deri në ditët e sotme i kushtohet kujdes vetëm kishave ortodokse, të cilat me të padrejtë quhen *serbe*. Për këtë pjesën më të madhe të fajit e bartin përgjegjësit institucional dhe "profesionistët" e mbirë në Kosovën e pas luftës.

Në kuadër të studimit historisë së lashtë dhe në veçanti të historisë kishtarë, mendoj se Don Gaspër Gjini ka dhënë një kontribut të çmuar duke i vënë bazat për studimin e historisë kishtarë dhe të kishave, por puna e tij duhet vazhduar dhe thelluar. Nga studimi i tij, pos tjerash, kam parë se në Prizren kanë ekzistuar disa kisha katolike, njëra prej tyre ajo e Shën Anës, që sipas hulumtimeve të mija duhet të ketë qenë në afërsi të Kishës së Shën Premtes. Përvetësimin e objekteve sakrale nga popullata shqiptare e dëshmon më së miri Kisha Shën Premtes në Prizren, e cila është ngrehur mbi tempullin e periudhës romake dhe të bazilikave të shekujve V-VI, XI e XIII. Pas rindërtimit nga mbreti serb Milutin (1307), kisha u përvetësua dhe u ripërkushtua „Të ngriturit të Zojës në Qiell“. Përkundër emërimit të ri, banorët vazhduan ta quajnë Kisha e Shën Premtes, në bazë të së cilës edhe serbët e quajtën *Sveta Petka*. Me këtë rast mbase duhet theksuar edhe konstatimin e K. Jirecek, i cili për shqiptarët thotë se *duken në mesjetë si popull i vjetër i krishterë me kulturë më të lartë urbane, e cila është shumë më e afërt grekëve dhe romanëve dalmatin se sa serbëve të posa pagëzuar*.

Drita: Cilat pasuri të trashëgimisë sonë kulturore, fetare dhe kombëtare akoma nuk janë kthyer prej Beogradit dhe cila është situata e gjithë këtij thesari?

Numri është i madh sa i përket trashëgimisë së çmuar arkeologjike, sidhet trashëgimisë së plaçkitur etnologjike dhe të dokumentacionit nga Instituti për Mbrojtjen e Trashëgimisë së Kosovës, para intervenimit të NATO-s. Thesari arkeologjik, i marrë nga Muzeu i Kosovës, nga Muzeu Arkeologjik i Prizrenit dhe nga Muzeu i Mitrovicës, është marrë me 'leje' dhe është përcjellë në Beograd me nënshkrimin e arkeologëve të Muzeut të Kosovës, Kemal Luci dhe Fatmir Peja, për hapjen e ekspozitës *Arheolosko Blago Kosova i Metohije*. Kjo ka ngjarë në kohën kur lufta e armatosur në Kosovë kishte nisur. Dëmet për mospërfiljen e paralajmërimeve të mija dhënë kolegëve të muzeut janë tejet të mëdha dhe si po shihet duhen ende përpjekje që thesari arkeologjik të kthehet në vendin e krijimit.

Drita: Ju jeni shqiptare, babën shqiptar të besimit mysliman, nënën shqiptare të besimit katolik, njihni gjuhën turke, keni studiuar në Beograd. Zonja Shukriu si ndjehet, kush ndjehet, cila është ajo sot?

Përkatesia me origjinë dy besimeve më ka mundësuar që t'i njoh dhe t'i kuptoj në thelb që të dy religjionet aq sa më ka mundësuar të kuptoj dhe të ndiej se ne shqiptarët jemi evropianë. Studimi në Beograd më ka mundësuar pikë së pari ta njoh veten dhe vendin e popullit tim në krahasim me të tjerët në ish Jugosllavi, ta njoh më afër popullin serb, por edhe të tjerët, ta shoh më për së afërmi ndikimin e Kishës ortodokse serbe dhe të Akademisë Serbe të Shkencave

“ Të orientuar kah përëndimi që herët edhe me stërgjyshërit tanë të krishterë, ne e kemi në vete gërshetimin e kulturës që ajo bart, si dhe fenë dhe kulturën që u përhap me pushtimet osmane. Për besimin e krishterë të të parëve ka shumë fakte, por këtë më së miri e dëshmon p.sh. festimi i Shën Gjergjit, të cilin popullata myslimane shqiptare me gëzim e pret, apo vajtja në Letnicë. ”

dhe të Arteve.

Sot, si edhe dje, jam shqiptare që përpiqet përmes punës dhe respektit ta gjëjë Zotin në vete, për t'i ndihmuar vetes dhe të tjerëve.

Drita: Është diskutuar mjaft në vitet e fundit për identitetin tonë shqiptar dhe për përcaktimin e tij euro-perëndimor. Cili është mendimi juaj?

Kontributi ilir-arbëror-shqiptar për zhvillimin e kulturës europiane, dhe jo vetëm për këtë, është i konsiderueshëm. Është çështje tjetër sa të tjerët kanë qenë të interesuar që ta shpalosin këtë apo sa ne kemi arritur t'i studiojmë çështjet që lidhen edhe me veten tonë dhe ta ndriçojmë këtë kontribut që nga thellësitë e kohëve. Në librin *Gratë e shquara shqiptare* jam përpjekur ta vë në pah këtë kontribut me prezantimin e grave të njohura, duke u nisur nga periudha antike. Mendoj se duke qenë në udhëkryq gjeo-strategjik dhe në ato historike, kemi kontribuar dukshëm në lidhjen midis Perëndimit dhe Lindjes dhe mund të kontribuojmë më tej.

Të orientuar kah përëndimi

që herët edhe me stërgjyshërit tanë të krishterë, ne e kemi në vete gërshetimin e kulturës që ajo bart, si dhe fenë dhe kulturën që u përhap me pushtimet osmane. Për besimin e krishterë të të parëve ka shumë fakte, por këtë më së miri e dëshmon p.sh. festimi i Shën Gjergjit, të cilin popullata myslimane shqiptare me gëzim e pret, apo vajtja në Letnicë (Cërnaqore, si i thoshin të parët tanë).

Mendoj se organizimi i pelegrinazhit në Letnicë, në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare, do të ishte në të mirë të këtij lokaliteti të shenjtë dhe të sfidimit të identitetit tonë. Për këtë mendoj se ekzistojnë parakushte të shumta, disa prej të cilave e shfrytëzoj rastin që t'i theksoj: 1) njihet me shekuj si vend i shenjtë përkushtuar Shën Marisë, 2) me shekuj në drejtim të tij janë zhvilluar pelegrinazhe, 3) pelegrinazh në Letnicë ka bërë edhe e madhja Nënë Tereza dhe aty mori vendimin për t'u përkushtuar rrugës së Zotit, dhe 4) në afërsi gjenden lokalitete arkeologjike, parahistorike dhe të periudhës romake.

Drita: Disa kanë vënë në dyshim origjinën e heroit tonë kombëtar Gjergj Kastriotit. A mund të na thoni opinionin tuaj, nga ana historike, në lidhje me këtë?

Mendoj se për origjinën e Gjergj Kastriotit flet mjaft fakti se vetëm shqiptarët e konsiderojnë hero kombëtar, ndonëse për kontributin e tij janë shkruar mjaft vepra edhe nga autorët e huaj.

Drita: Okupimi turk dhe ai serbo-sllav kanë qenë tragjike për historinë e kulturës dhe të trashëgimisë së popullit shqiptar. A mund të na thoni, cilat janë fushat, të cilat e kanë lënduar më së fortë këtë trashëgimi?

Sfidë mjaft e rëndë për ruajtjen e identitetit shqiptar ishte sundimi i shtetit mesjetar serb (1275-1455), kur popullata kishte presion tejet të madh për t'u bashkëngjitur Kishës ortodokse serbe dhe për t'u konsideruar

serbë. Pushtimet osmane e ndalën sadopak këtë trysni, u ruajt mjaft vazhdimësia e identitetit kombëtar, përkundër konvertimit të popullatës në faza të ndryshme në islamizëm, në masë të madhe nga fundi i shekullit XVIII. Si pasojë e këtyre eceakeve historike dhe të regjimit shumëvjeçar komunist, janë lënë pas dore kishat që janë ndërtuar në Kosovë nga shekulli IV dhe që kanë qenë në shërbim të popullatës autoktone dhe një pjesë e tyre është përvetësuar pastaj nga serbët. Ka fusha të shumta ku është lënduar trashëgimia, por mendoj se shkak të rërimi institucional serb të objekteve të identitetit shqiptar para dhe gjatë luftës në Kosovë, është anakronizëm dhe vandalizëm i llojit të veçantë. Kur kishat parasysh se i njëjti regjim bombardoi edhe qytetin e çmuar si është Dubrovniku, për atë popull që e udhëheq një regjim të tillë duhet ndërjer vetëm keqardhje. Është po ashtu tejet e dëmshme që vendimmarrësit ndërkombëtarë, kanë lëshuar pe ndaj presioneve politike serbe dhe kanë lejuar ndarjen e trashëgimisë së përbashkët kosovare në baza etnike, duke e vequr atë ortodokse dhe duke e cilësuar vetëm si serbe. Kështu u lejuua krijimi i eks-territoreve në Republikën e Kosovës dhe u lejuua ngritja e mureve rrethuese. Veprimet e tilla, gjithnjë duke pasur parasysh se kultura shpirtërore e reziston trysnive dhe kohëve, mund të jenë destabilizuese, aq më tepër kur kishen parasysh ngjarjet e marsit 2004, të cilat nuk dëshirojmë të përsëriten.

Drita: Duke ju falënderuar për zëmbërsisht për kohën, ju kërkoi që ta drejtoni porosinë tuaj për lexuesit e revistës sonë "DRITA".

Të kontribuojmë për të mirën kombëtare dhe të mirën e përgjithshme, se vetëm përmes saj edhe ne mund të na përfshijë e mira, dashuria dhe respekti.

(Intervistoi: don Jeton Thaqi)

Kisha e Kryengjyëve në Prizren



Ushqyes i urrejtjes – predikues i Dashurisë

■ SHKRUAN:
Don Marjan UKAJ, Toronto

“Besimi është një shpend, i cili këndon kur nata është akoma e errët” – thoshte Tagore. Pikërisht kjo u realizoi me jetën e Palit, i cili në fitoi besimin drejtpërdrejt nga Krishti i ringjallur. Ky besim ka një forcë transformuese të jashtëzakonshme dhe manifestohet me një jetë krejtësisht e lënë në dorë të Krishtit. Drita e Damaskut ishte aq e fortë sa që krejtësisht e shkriu urrejtjen në Saulin dhe e mbolli dashurinë, e flaku të vjetrën, për ta lindur të renë. Sauli e filloi rrugën e vet të re pa kurrfarë përgatitje, apo pajisje. Në momentin e thirrjes në cantën e tij nuk gjendej asnjë doracak uratash, veçse municion dhe armatim kundër të krishterëve, e ky fakt tregon se logjika e tij nuk e njihje tolerancën fetare. Atë që Zoti e zgjedh, e pajis me armët e tij. Saulit nuk iu desh shumë kohë për ta kuptuar, sepse forca e të Ringjallurit ishte më e fortë se mëkati i tij. Përgatitja e shpejtë për pagëzim dhe kalimi nga njëri ekstrem në tjetrin, nuk është meritë e Saulit, por e Krishtit (krh. Gal 1, 11-12). Pali, “krijesë e re në Krishtin”, e filloi jetën në pendesë dhe agjrim për t’u armatosur mandej me dije dhe dashuri. Tre ditë në Damask dhe tre vite në shkretëtirën e Arabisë do t’i vlejnin për një përgatitje të denjë në rrugën që e priste. Shpeshherë ndodh që njeriu të humbasë të gjitha gjërat që posedon dhe të fillojë gjithçka nga fillimi. Në qoftë se e kemi përjetuar këtë gjë në lëkurën tonë, atëherë e dimë se sa vështirë është. Si ishte kjo për Palin? Nga jeta e tij mësojmë se thirrja e tij nuk ishte aspak e lehtë (krh. 2 Kor 11, 16-30). Megjithatë, përvoja e Damaskut dhe hiri i Krishti e ndihmuan që ta përballonte çdo vështirësi dhe të shndërrohej në një teolog me të spikatur të Kishës.

Në 14 letrat e tija Pali ia la Kishës një thesar të paçmueshëm, ku për kah rëndësia teologjike dallohet letra e Romakëve dhe ajo e Galatasëve. Hapi i parë për të ishte pranimiti i mesimit të ri që bazohej në besimin e bashkësisë së Jeruzalemit, se Jezusi është Mesia (greqisht: Christós = i vajuari). Meqë ishte i thirrur në mënyrë të drejtpërdrejt nga Krishti, Pali në qendër të vëmendjes nuk e ka Atin, por Birin e tij Jezu Krishtin. Hiri i dhuruar e ndriçoi ta kuptonte dashurinë e madhe të Atit, i cili e flijoi Birin për të gjithë njerëzimin, pra edhe për paganët. Thyerja më

e madhja e tij teologjike është konstatimi se shfajësimi nuk fitohet me anë të Ligjit, por me anë të fesë në Krishtin: “Jo, unë nuk e hedh poshtë hirin e Hyjit, sepse, në qoftë se shfajësimi po u fituak me anë të Ligjit, atëherë Krishti ka vdekur kot (Gal, 2, 21). Pali të gjithë teologjinë e vet e bazon në vdekjen dhe ngjalljen e Krishtit. Kush beson në këtë, bën pjesë në grupin e të shpëtuarve. Për këtë arsye Pali heq dorë nga ligjet judaike. Dashuria si zbatim i përsosur i Ligjit është nxitje për çdo të krishterë që, t’i flakim larg veprat e errësirës e të ngjishemi me armët e dritës. Të ecim me nderë, porsì ditën, jo në gosti e zdhërrallje, jo në fëlligësi e në shfreni, jo në grindje e në smirë (Rom 13, 12-13; krh. Gal 5).“ Ky është ligji i ri i Krishtit që duhet ta përmbush çdo besimtar.

Vendimtare për kuptimin e teologjisë së Palit është pritja e afërt e kohërave të fundit „parusia“. Kjo temë spikat në Letrën e parë drejtuar Selanikëve dhe ka sjellë mjaft tolloni në popull. Mësimi: „Këtë ju themi të themeluar në faljen e Zotit: ne që jemi gjallë, që do të ndodhim gjallë në Ditën e Ardhjes së Zotit, nuk kemi për të qenë para atyre që kanë vdekur (1 Sel 4, 15)“, si dhe shprehjet tjera ndikuan që disa të thoshin: „Ja, Dita e Gjyqit! S’kemi pse të punojmë!“ Kjo ndikoi që të përjetonin një dimër shumë të vështirë. Prandaj, Pali u nxit ta shkruante Letrën e Dytë, në të cilën i qortoi: „Mos lejoni t’ju gënjejë kush në asnjë mënyrë! (2, 3) Kush nuk do të punojë, as mos të hajë! (3, 10)“

Nga marrja e thirrjes për apostull të paganëve theksi i tij ishte vu në pohimin: Nuk duhet të jesh jude për t’u shpëtuar. Prandaj, për këtë gjë sa më shpejt duhet të informohen të gjithë, pra, edhe paganët. Të gjithë njerëzit duhet ta dëgjojnë lajmin, se vetëm besimi në Krishtin shpëton. Pali lejon që përparësia e judenjtë të vazhdojë (Rom 9-11), por edhe ata që s’janë judenj, nëse e pranojnë fenë, me ngjalljen e Krishtit janë futur në rrethin e të shpëtuarve (Gal 3-5).

Teologjia e shën Palit tregon se Krishti përmes vdekjes së vet në kryq e fitoi vdekjen dhe mëkatin. Sipas tij, vdekja e Krishtit ishte e domosdoshme për shëlbimin e njerëzve. Andaj, nga ligji nuk mund të shpëtojë kush, sepse po të ishte kjo e sigurt, atëherë vdekja e Krishtit nuk do të ishte e domosdoshme (krah. Gal 2, 15-21). Pali thekson se nuk është Ligji judenj ai që na tregon rrugën për në qiell, por feja. Pali argumenton se Zoti përpara ia ka dhënë Abrahamit premtimin

e shpëtimit dhe pastaj e dha ligjin për ta mbrojtur njerëzimin nga fuqia e mëkatis. Me dërgimin e Krishtit fuqia e mëkatis ra. Krishti është përmbushja e premtimit të shpëtimit dhënë Abrahamit. Ligji do të funksiononte si mbrojtje, e jo kurrë si shpëtim.

Pagëzimi në fenë e krishterë luan rolin kryesor. Njeriu i pagëzuar bëhet krijesë e re në Krishtin. Pali këtë e dëshmoi edhe në mënyrë të jashtme me ndryshimin e emrit nga Saul në Pal. Ndryshimi i emrit do të thotë ndryshim jete. Paraqitja e Krishtit të ringjallur e goditi Palin në atë masë, sa që mos të llogarisë më në asnjë forcë të veten morale dhe intelektuale. Nga ai moment Pali mbështetjen e vet do ta gjejë në Krishtin. Ai është spiranca në të cilin do të kapet e ardhmja e tij, shpresa ku do të mbështetet, dashuria së cilës do t’ia kushtojë jetën. Ai tanimë e kuptoi se Krishti është burimi i dijës, dashurisë dhe i mirësisë dhe këtë kurrë më s’do ta harrojë. E kuptoi se Krishti s’ka nevojë për shikues, por për lojtarë. E kuptoi se Ai e kërkon jetën e tij. Në këtë takim Zoti i ringjallur ia shndriti mendjen për t’i kuptuar misteret më të thella të fesë: atë të Trinitë shenjtë, të Kishës si trup mistik i Krishtit, të sakramente si burim të shëlbimit të njerëzve, të lutjes, por, para së gjithave misterin e Kryqit. Pali, jo vetëm që i kuptoi këto mistere, por u bë edhe rob i tyre (krh. Fil 3, 12; 2 Kor 1, 1; Ef 1, 1; Kol 1, 1; Fil 3, 7-8). Kjo është domethënia e pagëzimit: varësi nga Krishti. I pagëzuari duhet të jetë i ndërgjegjshëm për këtë realitet të ri siç ishte Pali, i cili tërë jetën e vetë e bazoi në këto fjalë: „Jetoj, por jo më unë, në mua jetojnë Krishti“ (Gal 2, 20). Pali tani i jep hapësirë Krishtit të jetojë në të. Ai ia hapë dyertë e zemrës së vet, tashmë të pastruar me ujin e pagëzimit, që Ai të mbjellë në të një farë të re, farën e krishterë, farën e dashurisë.

Shikimi në Krishtin e kryqëzuar ia zbulon një fshetësi tjetër e kjo është: s’ka dashuri pa flimim. Krishti vdiq në kryq për ne, pra edhe ne duhet të flijohemi për njëri-tjetrin. Pali u bë rob i Fjalës së Zotit: „Shkrimi shenjt, hyjnisht i frymëzuar, është i dobishëm për të mësuar, për të bindur, për të ndrequr, për të edukuar në drejtësi, që njeriu i Hyjit të jetë i përsosur, i përshatur për të kryer çdo vepër të mirë (Tim 3, 16-17)“. Ungjilli u bë jeta e tij, ndër-



sa kryqi fitore.

Ai tash është ushtar i kryqit të Krishtit i armatosur me dashuri. Me atë dashuri, me të cilën Ati e flijoi Birin e vet dhe me të cilën Biri e dëgjoi Atin. Pali i çarmatosi armët e shekullit dhe u armatos me armët hyjnore: „Në të vërtetë, edhe pse jetojmë në trup, nuk luftojmë simbas parimeve të trupit, - sepse, armët e luftimit tonë, nuk janë armë lëndore, por armë të fuqisë së Hyjit të afta të shkatërrojnë kështjellat - ne rrezojmë e hedhim për dhe sofizmat e njerëzve si edhe çdo kreni që ngrihet kundër pranimit të Hyjit (2 Kor 10, 3-5).“ Ai u bë model i të pagëzuarit, shëmbëlltë e përsosur e njeriut të rilindur nga uji dhe Shpirti Shenjt: „Pra, nëse ndokush është në Krishtin, është krijuar e re: e vjetra u zhduk, dhe, ja, u bë e reja! (2 Kor 5, 17)“ Ky është ai njeri model, për të cilin i foli Krishti Nikodemit: „Përnjëmend, përnjëmend po të them: kush nuk lind përsëri prej së larti, nuk mund ta shohë mbretërinë e Hyjit...kush nuk lind me anë të ujit e të Shpirtit nuk mund të hyjë në Mbretërinë e Hyjit (Gjn 3, 3, 5).“ Pali tregon si duhet të sillet një i pagëzuar. Ai duhet të jetë i vetëdijshëm se vullnetarisht ia ka dorëzuar jetën e vet Krishti: „Ju e zhveshët njeriun e vjetër me veprat e tij dhe e veshët njeriun e ri që përtërihet në njohurinë e drejtë në përngjasim të Krijuesit të vet. (Kol 3, 9-10)“ Shpjegimi më i përsosur i pagëzimit qëndron në këto fjalë: „Po ju a nuk e dini se jeni Tempulli i Hyjit dhe se Shpirti i Hyjit banon në ju? Nëse ndokush e rrënon Tempullin e Hyjit, Hyji

do ta humbasë atë, sepse Tempulli i Hyjit është i shenjtë - e ky Tempull jeni ju! (1 Kor 3, 16-17)“ Të ndalemi pak dhe ta pyesim vetëm: çfarë është për mua pagëzimi? A është një larje vetëm me ujë, apo me ujë dhe Shpirt Shenjt? A tregon përkohshmërinë, apo amshimin? A është një vullë e zbardhë nga arkivimi i dobët, apo një vullë, të cilin nuk mund ta shlyejnë as „dyert e ferrit“? Pali ishte krenar me pagëzimin e vet (krh. 2 Kor 11, 23-27, 30; 12, 10). Ai këtë e dëshmoi gjithkund. Si jemi ne? A krenohemi me kryqin e varur në qafë, apo me vepra? A punojmë për krenarinë tonë, apo për atë të Krishtit? A kemi forcë të dalim në publik, në sheshe, në vende të punës, në bashkësitë famullitare etj. dhe pa komplekse dhe ekzagjerime të dëshmojmë mbi Krishtin dhe Kishën e tij të cilës i takojmë me pagëzim? Nëse na mungon diçka nga kjo që e përmendëm, atëherë duhet mjekuar fenë tonë. „Ja, unë po ju dërgoj porsì dele midis ujquish! Jini, prandaj të mençur porsì gjarpërinjë dhe të thjeshtë porsì pëllumbat! (Mt 10, 16)“

Pagëzimi na bën apostuj (apostoleo - fjalë greke që d.m.th. i dërguar), na dërgon si predikues të Ungjillit (evangelion - fjalë greke që në shqip d.m.th. lajm i gëzuar). Pali u bë dëshmitar i gëzimit në botë. Ai e dinte se për Ungjill i duhet të vuaj: „Nëse bota ju urren, dini se para jush më urreu mua (Gjn 15, 18).“ Por, ishte i vetëdijshëm se pagëzimi është shortim në trupin e Krishtit, i cili tha: „Unë jam hardhia, e ju jeni shermendat.

Kush mbetet në mua e unë në të, ai jep shumë fryt, sepse pa mua s'mund të bëni asgjë. Nëse ndokush nuk mbetet në mua, hidhet jashtë porsia shpirtërore e prerë e thahet. Të tillët i bashkojnë, i qesin në zjarr e digjen. Nëse mbeten në mua, dhe, nëse falët e mia qëndrojnë në ju, lypni gjithçka të doni dhe do t'ju jepet (Gjn 15, 5-7).“ Ai si nxënës i përkryer i Shkrimeve, i zgjedhur nga Krishti, e dinte se gjithçka mund t'i kërkonte Krishtit. Por, ai çuditërisht nuk kërkoi prej tij lavdi dhe pushtet, si do kërkonim ne, por kërkoi që të bëhet dëshmitar i kërqit të tij. U pagëzua në kryqin e dhuratë në të varrosi të gjitha dëshirat e kësaj bote. Të bërët i krishterë s'ishte për të një operim kozmetik, i cili e bënte pamjen tonë më të bukur, por fillim i ri, apo rilindje për Krishtin. “Materia është pjesë e sakramentit. Krishterimi s'është një realitet krejtësisht shpirtëror, por ai e përfshin edhe trupin dhe gjithësinë. Ai shtrihet në tokën e re dhe në qiellin e ri (Papa Benedikti XVI).“

Për Eukaristinë Pali ka një nderim të thellë. Në 1 Kor 10, 16-17 kemi një karakter personal dhe social të Eukaristisë. Krishti bashkohet me çdonjërin prej nesh, por i njëjti Krisht bashkohet me vëllanë dhe motrën që e kemi afër. Kështu, Krishti na bashkon të gjithëve me vetën dhe me njëritjetrin. Ne e marrim Krishtin në kungim, por, njëkohësisht Krishti bashkohet në mënyrën e njëjtë me të afërmin tim: Krishti dhe i afërmi janë të pandashëm në Eukaristi. Kështu të gjithë jemi një bukë, një trup. Një Eukaristi pa solidaritet me të tjerët është një keqpërdorim i Eukaristisë. Këtu hasim në rrënjët dhe njëkohësisht në qendër të mësimit mbi Kishën si Trup i Krishtit të ringjallur. “Pali e takoi Krishtin jo vetëm si drituri dhe sistem fetar, por si person. E pa një dritë të madhe dhe e dëgjoi një zë që i fliste. Besimi i tij është përjetim i të qenit i dashur në mënyrë personale nga Jezu Krishti. Besimi i tij s'është një teori, apo një mendim mbi Zotin dhe botën. Besimi i tij është shfaqje e dashurisë së Zotit në zemrën e tij (Papa Benedikti XVI).“ „Dilige et quod vis fac“ - duaj dhe bëj çka të duash - thotë shën Augustini, gjë që siç shihet është plotësuar me përpikëri në jetën e Pali.

Shën Pali hyn në bashkësi me Kishën. E pranon dhe nderon autoritetin e Pjetrit dhe Jakobit (Gal 1, 18). Në krahësim me ta ai është „dështak“ dhe „më i vogli ndër apostuj“ (1 Kor 15, 8; Tim 1, 12-14). Pali nuk mban asgjë për vete nga ajo që ka pranuar. Është i bindur se duhet t'i gëzojë të tjerët me Lajmin e gëzuar. Pali din të bashkëpunojë me Barnaben, Silvanin dhe Timoteun dhe me të tjerët, me të cilët shkruan: Sosteni (1 Kor 1, 1), Timoteji (2 Kor 1, 1; Fil 1, 1; Kol 1, 1), Silvani (1 Sel 1, 1; 2 Sel 1, 1), Tit (2 Kor 12,

18), Tihiku (Ef 6, 21).

Kohës tonë Pali i jep shembull dhe kurajë për ta kërkuar dritën jetësore të Jezusit. Ai është nxitje që ta studiojmë dhe shqyrtojmë thellësisht Shkrimin shenjt për ta njohur si duhet qenien tonë. Jeta e Palit është një thirrje urgjente që sa më shpejt të aktivizohemi në jetën dhe punën e Kishës. Besimtari i Krishtit nuk do të lejojë që lufta dhe Mesha të mbeten pa dashuri konkrete ndaj të afërmit.

Ngjallja e Krishtit është një ndër temat kryesore të letrave të tij, të cilat i takojmë në përshëndetjet solemne (Rom 1, 4; Gal 1, 1), në falënderim (1 Kor 1, 9; 1 Sel 1, 10), si mendim përcjellës (Rom 4, 24; 7, 4), apo si qendër e diskutimeve sistematike (1 Kor 15). Në ngjalljen e Krishtit shikon përmbushjen e Shkrimeve dhe lajmëron si edhe vet ka hyrë në vargun e dëshmitarëve. Ai është „dështak“, por Bariu i Mirë e gjen atë si delen e plagosur dhe të humbur. Për këtë arsye ai u bë apostull edhe pse nuk e ka përcjellë kurrë Mësuën nga Nazareti. Pali shumë shpesh mediton mbi fshehtësinë e Atit qiellor. Në Zotin Atë e njofton fuqinë, e cila Birin e mishëruar e ngritë nga të vdekurit dhe e kthen në jetë. Lavdia e Atit është fuqia, e cila Jezusin e ngriti nga varri (Rom 6, 4), ajo e vetmja e meriton besimin tonë (2 Kor 1, 9). Për të e vërteta e Pashkëve është e thjeshtë: „Zoti e ngjalli Jezusin“ (1 Kor 15, 15) Ngjallja në sytë e Palit është një veprim liturgjik: „Ai është fryti i parë i të vdekurve“ (1 Kor 15, 20). Sipas Palit Jezusi „vdiq për të gjithë, në mënyrë që ata që jetojnë, të mos jetojnë më për vete, por për atë që vdiq dhe u ngjall për ta (2 Kor 5, 15).“ Ngjallja e Jezusit është një fakt i pamohueshëm në të cilën e gjënë themelin e predikimit dhe themelimit të fesë (1 Kor 15, 17). Në ngjalljen e Jezusit, Pali e shikon jetën e pasosur: „E në qoftë se vdiqëm bashkë me Krishtin, besojmë se edhe do të jetojmë bashkë me Të, mbasi e dimë se Krishti i ngjallur nga të vdekurit, nuk vdes më: vdekja nuk ka më pushtet mbi Të (Rom 6, 8-9).“ Krishti i ringjallur është arsyeja dhe shkak i jetës sonë (krlh. Rom 6, 4). Ai do t'ia shpërblejë çdonjërit mundin që bën për Zotin dhe njeriun, sikurse ia shpërbleu shën Palit, Prandaj, të nxitur nga kjo thirrje, të jetojmë edhe ne si ai që, në fund, së bashku me të, të kemi mundësi të themi: „Luftën e mirë e luftova, vrapimin e krevat, fenë e ruajta (Tim 4, 7). Nitsche pat thënë: „Me të Kryqëzuarin do të mund të debatoja, por ai Pali po më mundon shumë.“ Le ta lusim Zotin që kjo thënie të mos bëhet realitet edhe i popullit shqiptar.

- vazhdon -

Një jetë në shërbim të Zotit dhe Njeriut

(Përkritazi me librin “Motra Otilia, nëna e të sëmureve dhe e të varfërve në Kosovë”, e

autores M. Slavica Buljan, përkthyer në shqip nga Don Marjan Demaj)

■ SHKRUAN:
Ndue UKAJ

Historia e Kishës Katolike është e mbushur me personalitete të shumta, të cilët, me veprimtaritë e tyre të prekshe tokësore, me shërbimet misionare, kanë përmbushur në formën më të mirë Ungjillin e Shenjtë, kuptimin e vërtetë të tij, si në dimensionin tokësor, njashtu edhe në atë qiellor. Në këtë panteon hyjnë shumë emra të mëdhenj, të cilët kisha i nderon dhe me të cilët kisha demonstroi rolin e saj të përhershëm e universal, për Zotin dhe Njeriun. Ndërkapa, po në këtë aspekt, një personalitet tejet i rëndësishëm, shumë i devotshëm, mbetet pa mëdyshje, pikërisht një motër e zakonshme nderi, e ardhur nga Gjermania moderne, për të shërbyer në mjerimin më të rëndë të Kosovës - Motra Otilia, e cila, tërë jetën e saj, ka shërbyer në këto hapësira shqiptare, me një theks të veçantë, në rajonin lënjë krejtësisht pas dorës të Karadakut, aty ku jeta ishte më se e vështirë, një jetë bizare, me mungesa të panumërta. Mbese, parë nga prizmi gjerman, do të mund të thoshim, një jetë e paimagjinueshme e me të cilën ajo ishte mishëruar me shpirt e mendje.

Në historinë kishtarë kemi shumë shembuj të veçantë, kuptimplotë e shumë të devotshëm, që tregojnë se si njeriu, i cili beson në forcën e ungjillit, arrin të bëjë gjëra të mëdha, madje aq të mëdha, sa për mendjen njerëzore duken të paimagjinueshme. Në të vërtetë, këto janë mrekulli të ndryshme. Kur e lexova librin “Motra Otilia, nëna e të sëmureve dhe e të varfërve në Kosovë”, të shkruar me një elokuencë nga m. Slavica Buljan dhe të përkthyer po ashtu me një përkushtim dhe kulturë nga misionari don Marjan Demaj, kuptova se është pikërisht forca e besimit ajo që tejkalon shumëfish të gjitha barrierat e kësaj bote. Dhe, këtë me gatishmërinë për të flituar. Në dukje të parë, kjo është një e arrire e lehtë, por, kur lexojmë dhe përjetojmë peripecitë

e pashembullta të Motrës Otilia, e kuptojmë se kjo punë gjigante, mund të bëhej vetëm nga njerëz të mëdhenj, të cilët besojnë palëkundshëm, nga njerëz që kanë cilësi shenjtërie, tipare këto që i kishte Motra Otilia gjatë gjithë jetës dhe veprimtarisë së saj. Mbese, kjo bëhet nga njerëz që kanë dashuri të madhe për Zotin e Njeriun, të tillë që udhëhiqen e priren nga ideale superiore, pra Hyjnore. Kur lexova këtë libër, kuptova se si drithërimat dhe makthi i jetës, përmes buzeqeshjes dhe dashurisë, mund të mposhten dhe të kthehen në gëzim e lumturi. Pikërisht këtë gjë e bëri në çdo hap të jetës së saj, Motra Otilia, e cila sfidoi shumë të pamundura, vetëm me

Në të vërtetë, personaliteti shumëdimensional i Motrës Otilia, është një fenomen më vete, një model i shkëlqyer për çdo njeri e besimtar, për çdo dashamir të përparimit në fe e mirëqenie shoqërore.

Libri trajton në shumë dimensionet jetën e një personazhi krejtësisht të veçantë; jetën e Motrës Otilia, e cila lenë Gjermaninë për malet e Karadakut. Libri këtë personazh e vështron në plane të ndryshme, me dëshmi dhe të gjithanshëm, nga bamirësitë e saj, të cilët e kanë përcjell gjatë jetës së tyre. Libri shqyrton në shumë aspekte marrëdhëniet e saj me popullsinë e rajonit ku shërbeu ajo, me kishën, me bamirësitë, me Zotin dhe Ungjillin, me motrat tjera që e përcollën çdo kund. Kësioj, libri mbetet një kronikë e shkëlqyer e një jetë të jashtëzakonshme. Libri ndjek një kronologji, që përcjell natyrshëm Motrën Otilia, që nga rinia e hershme, deri në kalimin e saj në Amshim. Duke përfshirë një jetë të tërë, të bujshme dhe të mbushur me ngjarje të jashtëzakonshme, ky libër gjithsesi është edhe një dëshmi e veçantë për peripecitë e Kishës shqiptare ndër kohë. Së këndejmi, libri duhet tumiret si vepër e një rëndësie të veçantë, për edukimin në fe, në vepra dashurie, në

vepra misionare. Mbi të gjitha, ky libër është një dëshmi e fortë se si forca e besimit, e guximit për të besuar pa asnjë dilemë tek Zoti, mund të ndryshojë jetën e shumta. Në këtë aspekt, kontributi i don Marjan Demaj, përkthyesit të librit, duhet vlerësuar si tejet i rëndësishëm, për faktin se ai i ka ofruar lexuesit shqiptar një vepër me vlera të mirëfillta. Një dëshmi e një jete në shërbim të Zotit e Njeriut. Andaj në rrugët e konsolidimit shqiptar, pas jo, ky libër mund të ndihmojë për të kuptuar se si përmes dashurisë dhe veprave të tyre, mund të ndihmohet njeriu. Këtu e hasim një analogji me të madhen Nënë Tereze. Lutjen/poezi të Nënës Tereze se “Jeta është sfida, sfida”, Motra Otilia gjithë jetën e bëri parim udhëheqës. Prandaj edhe vepra e saj, ashtu sikurse ky libër, sfidon kohë.



një armë, besimin dhe dashurinë për Njeriun e Zotin, gjë të cilën e dëshmojnë me dhjetëra personazh që flasin për të në këtë libër. Prandaj, si i tillë ky libër është i mirëseardhur për çdo kosovar, mbi të gjitha, ai është i rëndësishëm për atë që besojnë, për ata që duan ta kuptojnë rolin e fesë në jetën e njeriut, për ata që duan të kuptojnë se është pikërisht fuqia e Zotit nëpërmjet njeriut që transformon jetën. Ka shumë sosh personazhe që njihen për veprimtaritë e tyre të fushave misionare, mirëpo, gjithsesi libër “Motra Otilia, nëna e të sëmureve dhe e të varfërve në Kosovë”, përbën një fenomen të rrallë. Prandaj, ky libër brenda kulturës shqiptar mbetet me rëndësi të posaçme, jo vetëm me materialin e gjerë informues që ngërthen, por edhe për rolin edukativ që ka.

Debora

- gruaja e lavdisë së Zotit

SHKRUAN:
Don Lush GJERGJI

*"Ngrihu, ngrihu, o Debora,
ngrihu, ngrihu e thuaja këngës"
/Gjy 5, 12/.*

Debora, emri i së cilës domethënë *"bletë"*, ishte gjykatëse dhe profeteshë e Izraelit, gruaja e Lapidotit.

Bibla shkruan për të kështu: *"Tek ajo shkonin izraelitët për çështje pleqërie" /Gjy 4, 5/.*

Debora e kishte këshilluar Barakun, birin e Abinoemit, që të luftonte kundër Sisarës, prijësit të ushtrisë së Jabimit, të cilin do ta mundte me fuqinë e Zotit.

Ja fjalët e saj:

"Do të vij, po, me ty; por kësaj here nderi nuk do të mbesë ty! Sepse Zoti do t'ia lëshojë në dorë Sisarën një gruaje" /Gjy 4, 9/.

Debora pati dy role vendimtare: ishte gjykatëse dhe profeteshë në shekullin e XII para Krishtit, në kohën kur izraelitët ishin duke e marrë tokën e premtuar, por hasën në rezistencë të madhe nga ana e kananeut Hazor, i cili kishte një mbretëri të forte dhe një ushtri gati të pathyeshme.

Mirëpo, Zoti nëpërmjet një femrës, gruas, do t'ia japë fitoren, ngadhënjimin.

"Debora i tha Barakut:

"Ngrihu, erdhi dita kur Zoti po ta lëshon në dorë Sisarën! Qe, vetë Zoti po të prin!"

/Gjy 4, 14/, sepse mu në dobësinë e njeriut dëshmohej fuqia e Zotit.

Debora, sipas traditës së krishterë, është paralajmërimi dhe simbolizimi i Virgjërës Mari, asaj e cila do ta mposhtë Djallin dhe sundimin e tij.

Këtë lidhje dhe paralelizëm e gjejmë së pari te Shën Pali i cili shkruan kështu:

"Por, Hyji i zgjodhi të marrërt në sy të botës, për t'i turpëruar në mënyrë të fortit" /1 Kor 1, 27-28/.

Vlerësimi i dytë vjen nga përvoja dhe jeta e Kishës, saktësisht nga Shën Jaku, i cili thotë:

"Dëgjoni, vëllezër të mi të dashur! A nuk i zgjodhi Hyji ata që për sy të botës janë skamnorë për t'i bërë të pasur me fe dhe trashëgimtarë të Mbretërisë që ua ka premtuar atyre që e duan? E ju e përbuzni skamnorin?" /Jak 2, 5-6/.

Kështu ndodhi edhe në tërë Besëlidhjen e Vjetër, si për shembëll:

Moisiu, endacaku i përndjekur, i cili s' dinte as të fliste mirë /krh. Dal 3, 4 dhe 6/, dhe fare nuk ishte i aftë për dërgimin e Zotit, dhe pati shumë arsye për t'u këndërshtuar planit të Hyjit. Atë, e jo vëllaun e tij Aronin, gojëtarin e mirë, e zgjodhi dhe e dërgoi Zoti që t'i printe popullit të zgjedhur kah liria dhe toka e premtuar!

Davidi, vëllai i fundit, të cilin e kishte zgjedhur Zoti nëpërmjet Samuelit /krh. 1 Sam 17-31; 2 Sam 2-3/ si dhe në rastin e Jakobit, i zgjedhur para të paralindurit Ezaut.

Po ashtu edhe dyluftimi mes Davidit dhe Goliatit ishte i pabarabartë, sepse Goliatit ishte ushtarak profesional, i veshur dhe armatosur deri në dhëmbë, kurse Davidi i kundërvijë atij vetëm në emër të Zotit. Dhe ngadhënjëu, sepse Zoti ishte me të dhe me popullin e tij.

Hapi i parë i këtyre njerëzve të Zotit, si Moisiu, Davidi, Debora e shumë të tjerë, është vetëdija e dyfishtë:

Kush është Zoti, i cili i kishte ftuar dhe dërguar ata për një mision, detyrë, plan, veprim;

Kush janë ata në vetvete dhe në planin, vullnetin dhe dërgimin e Hyjit, me ndjenjën e dobësisë dhe paaftësisë vetanake, por të fuqisë në bashkëpunim me Të.

Fuqia dhe dobësia gërshtohen, përplotësohen, janë mozaiku i fesë, kombinim i shpresës, janë përvoja dhe fuqia e dashurisë, e cila bën edhe mrekulli.

Debora i këndon veprat e Zotit dhe fitoren e tij mbi armiqitë e saj dhe të popullit të Izraelit /lexo dhe medito: Gjy 5, 1-32/.

Virgjëra Mari i këndon gjithëpushtetësisë së Zotit, i cili bëri vepra të mrekullueshme nëpërmjet saj, në himnin *"Shpirti im e madhëron Zotin" /Lk 1, 46-56/.*

Hapi i dytë është bashkëpunimi me Zotin, që lind nga feja – besimi në Të, zbatohet me dashuri. Bashkëpunimi me Zotin është parakusht i çdo pune, veprimtarie, suksesi, si dhe "shkollë" për bashkëpunimin ndërvëllazëror.

Hapi i tretë është shpallja e veprave të Zotit me fjalë dhe me gojë, por mbi të gjitha me jetë dhe me dëshmi, sepse nga vetëdija dhe bashkëpunimi lind doemos dëshmia e krishterë.

Debora e zbërtheu planin e Zotit dhe i këndoi veprat e



“Shën Jaku: dëgjoni, vëllezër të mi të dashur! A nuk i zgjodhi Hyji ata që për sy të botës janë skamnorë për t'i bërë të pasur me fe dhe trashëgimtarë të Mbretërisë që ua ka premtuar atyre që e duan? E ju e përbuzni skamnorin?”

tija në dobi të Izraelit, si edhe Virgjëra Mari, e cila krejtësisht ishte e Zotit, me Zotin dhe për Zotin, dhe vetëm si e tillë është bija e lavdishme e popullit të Zotit, Kishës.

Fytyrë e ngjashme me Deborën ishte edhe Gjedeoni, të cilin e thirri Zoti për t'i mbrojtur izraelitët nga medianët /krh. Gjy 6, 1-6/.

Emri i tij domethënë rrënim, asgjësim, sidomos rrënimi i elterit të Baalit, të cilin e kishte ndërtuar ati i tij, pra, lufta kundër besëtytnive të rrejshme /krh. Gjy 6, 25-32/.

Edhe Gjedeoni ishte i vogël, i dobët, askushi para syve të njerëzve, por me ftesën dhe ndihmën e Zotit, u bë tejet i madh dhe vetëm me 300 vetë fitoi, ngadhënjëu mbi kundërshtarët.

Shumica e ushtrisë së tij ishin gjujnjëzuar për të prirë ujë, shenjë ky i besëtytnisë, apo i adhurimit zotave të rrejshëm /krh. Gjy 7,

1-8/, të cilët Zoti i largoi prej luftës, sepse ata do të mund të lavdëroheshin se kanë fituar me luftën dhe me fuqitë e tyre.

Mu për këtë Hyji i tha Gjedeonit kështu:

"Ke tepër shumë popull me ty që të mund të lëshoj Medianin në duart e tija, sepse Izraeli mund të lëvdohet e të thotë: "Me forcat e mia u çlirova!" /Gjy 7, 2/.

Çfarë simbolizmi apo paralelizmi ka mes Gjedeonin dhe Virgjërës Mari?

Gjedeoni kishte kërkuar prej Hyjit një shenjë, një lloj prove dhe sigurie se Zoti vërtet do të jetë me të.

"Të mos ndizet flakë hidhërimi yt kundër meje, nëse edhe një herë po e marrë guximin të kërkoj shenjë në bashkë. Të lutem: le të jetë vetëm bashka e thatë, ndërsa mbarë toka le të jetë me vesë" /Gjy 6, 39/.

Sprova e parë ishte e kundërt: bashka le të jetë në lëmë dhe

vetëm atë le ta mbulonte vesa, ndërsa toka le të jetë e thatë apo e terur /krh. Gjy 6, 36/.

Bashka apo veli i lagur me vesë e toka e thatë, e paraqet Virgjërën Mari dhe botën njerëzore, të thatë, të robëruar dhe plot me mëkate, pa hirin e Zotit, si dhe plleshmërinë e saj virgjërore, Jezu Krishtin, vesën e botës.

Vesa për hebrejnë ishte shenjë e bekimit të Zotit, e plleshmërisë dhe dashurisë së tij për popullin e vet.

Hera apo sprova e dytë ishte bashka e thatë, pa vesë, kurse toka mbarë e mbuluar me vesë, që prapë simbolizon përjashtimin e Virgjërës Mari nga mëkati i rrjedhshëm dhe nga çdo lloj mëkati, e që qysh nga shekulli XII pas Krishtit e parafytyronte të zënit e Virgjërës Mari pa mëkat të rrjedhshëm.

ABC-ja bashkëshortore – martesore (I)

PËRGATITI:

P. Shtjefën Dodes SJ

Të jetosh i/e lumtur një jetë të gjatë me një njeri që e do, është gjë e arritshme! Dubet pranuar se këtu dubet pak veprim dhe angazhim. Dashuria në raste shumë të rralla mund të funksionojë vetvetiu – të paktën jo gjithmonë. Edhe pse kjo nuk tingëllon jo edhe aq romantike, ia vlen të investosh pak angazhim në partneritetin tuaj. Me këtë "ABC-ja bashkëshortore – martesore" mund të fitoni në këtë drejtim shumë nxitje.

A – afërsia; B – besimi; C – caqet (qëllimet); Ç – çiltërsia; D – dashuria (ndaj vetvetes); Dh – dhuratat; E – entuziazmi; Ë – ëndjet (të qeshurit); F – fëmijët; G – grindja; F – falja; Gj – gjallëria (pasioni); H – hapësirë veprimi; I – imazhi (pamja e jashtme);

A – Afërsia

Nëse jetojmë një kohë të gjatë së bashku, krijohet një lloj i veçantë afrimi. E njohim njëri-tjetrin si askush tjetër. E zhvillojmë një besim që nuk e kemi me askënd tjetër. Kjo afërsi lidh dhe e ndajmë veten këndshëm dhe na bën mirë. Edhe kur prej kohe në kohë ndoshta kemi nevojë për një distancë, prapë se prapë kjo afërsi nuk humb. Keni para sysh gjithmonë edhe ndjenjën e kësaj afërsie tuaj ndaj tjetrit. Nëse e lëni anash, mund të jetë një shenjë se diçka në mes jush më nuk është në rregull.

B – Besimi

T'i besosh njëri-tjetrit është një dhuratë e mrekullueshme. Besimi është i çmueshëm dhe mund të humbet lehtë. Besimi i humbur është vështirë të kthehet. Për këtë arsye, do të duhej patjetër ta keni para sysh që partnerin apo partneren Tuaj kurrë ashtu mos ta lëndoni që besimi të humbet.

C – Caqet (qëllimet)

Caqet e përbashkëta formojnë një lidhje të fortë në mes dy të dashurve. Edhe nëse e ka çdonjëri prej tyre jetën e vet – p. sh. për shkak të profesioneve, hobeve apo miqve të ndryshëm – do të duhej të vendosni qëllime të përbashkëta. Të synosh të arrish diçka së bashku është diçka e mrekullueshme. Të arrish diçka së bashku, ju bën më të fortë dhe forcon marrëdhënien. Dhe kështu e arrini më lehtë qëllimin Tuaj shumë të madh të përbashkët: së bashku të plakeni.

Ç – Çiltërsia

Tema e çiltërsisë apo transparencës shikohet nga çiftet të ndryshme në mënyra mjaft të ndryshme. Disa bëjnë be për çiltëri absolute, të tjerët prapë mendojnë se nuk është e thënë të tregohet gjithçka. Këtu kemi të bëjmë me atë që ju së bashku ta gjeni rrugën që për ju është e drejtë. Nuk ekziston "drejt" apo "gabim". Mirëpo, çiltëria në asnjë mënyrë nuk do të duhej të shfrytëzohej si alibi për ta ngarkuar tjetrin me shpërblim apo për ta lënduar. Natyrisht që njeriu mund të bisedojë për

gjithçka, mirëpo edhe këtu njeriu do të duhej ta ketë të qartë se toni e bën muzikën.

D – Dashuria (ndaj vetvetes)

Ç'domethënë "dashuri" për Ju? Zbuloni njëherë se a keni të dytë sa i përket kësaj çështjeje paramendime dhe pritje të ngjashme. Në të vërtetë, shpesh ndodh që dy të dashur fare nuk këmbëjnë mendime se çfarë kuptojnë me konceptin "dashuri" dhe çfarë dëshirojnë prej tjetrit. Rreziku i mosmarrëveshjeve apo zhgënjimeve natyrisht që këtu është shumë i madh. Pra, shkëmbeni njëherë mendime/qëndrime për këtë çështje.

Disa njerëz thonë se njeriu mundet vetëm atëherë të dashurojë nëse e do vetveten. Kështu ne mund ta pranojmë tjetrin për njëmend vetëm atëherë nëse ne vetveten mundemi ta pranojmë. Pavarësisht nga ajo se si e shihni Ju këtë apo jo, afërsia ta duash vetveten është diçka mjaft pozitive. Në një marrëdhënie ruajeni veten nga dyshimet e këqija në dashurinë e tjetrit. Ai që di ta durojë mirë vetveten ndikon shumë më pozitivisht dhe në mënyrë më të relaksuar në tjetrin. Pra, merrni dashurinë e partnerit Tuaj apo partneres Tuaj si bazë për të mësuar ta doni vetveten.

Dh – Dhuratat

Dhuratat e vogla përmbajnë jo vetëm miqësinë, por edhe dashurinë. Dhe më atë rast nuk kemi të bëjmë vetëm me dhurata të stërmëdha, të shtrënjta dhe mbresëlënëse të herëpashershme, por me një vëmendje plot dashuri. Kjo mund të ndodhë te blerja apo te pudingu i dashur, te një libër i zgjedhur ekzakt sipas shijes lexuese apo një masazh pas një dite të ngarkuar.

E – Entuziazmi

Entuziazmi (frymëzimi) është një ndjenjë shumë e fuqishme. Le t'ju bjerë në mend si keni qenë të entuziazmuar së bashku prej njëri-tjetrit, kur keni qenë të dashuruar në njëri-tjetrin. A nuk ka qenë atëherë çdo gjest, çdo fjalë, a nuk ka qenë ky njeri i tërë një nxitje e vazhdueshme për entuziazëm? Të rënit e parë në dashuri ndoshta ulët, mirëpo

Ju mundeni të entuziazmoheni në çdo kohë në mënyrë të re për partnerin Tuaj apo partneren Tuaj. Entuziazmohuni për dashurinë Tuaj të përbashkët, për atë çfarë Ju përjetoni së bashku, çfarë Ju tashmë bashkërisht keni arritur apo për gjithë atë çfarë Ju së bashku keni para sysh të bëni.

Ë – Ëndjet (të qeshurit)

Edhe nëse nganjëherë një marrëdhënie kërkon shumë punë, megjithatë fjala është para së gjithash për të qenë së bashku të lumtur. Të keni kënaqësi të përbashkëta, ndërmerrni gjëra të bukura së bashku, qeshni së bashku dhe shijoni të qenët Tuaj së bashku.

Të mund të qeshesh së bashku është një lloj sigurimi i partneritetit. Ai që mund të qeshet për marrëdhënien e vet dhe e ruan humorin, edhe kur nganjëherë vijnë kohët e këqija, ai tashmë e ka siguruar një ndihmë të madhe. Një humor i ngjashëm ndihmon shumë të vazhdohet rruga, sepse qeshja e përbashkët i lidh jashtëzakonisht njerëzit.

F – Fëmijët

Fëmijët janë për shumë vetë kurorëzimi i një marrëdhënie apo martese. Është diçka e mrekullueshme nëse prej një dashurie të përbashkët krijohet një jetë e re. Kjo mund të na bëjë shumë, shumë të lumtur. Mirëpo, ajo çfarë fëmijët nuk mund ta bëjnë është që marrëdhënies Tuaj t'i japë kuptim apo ta ndreqin një martesë tashmë të dërrmuar. Prej kësaj pastaj vuani jo vetëm Ju, sepse në pritjet Tuaja shumë e mundshme jeni zhgënjyer, por para së gjithash edhe fëmijët. Vendosni të keni fëmijë gjithmonë për shkak fëmijës, të mirës së tij, dhe jo për shkak të një arsyeje tjetër.

F – Falja

Në dashuri bën pjesë po ashtu të mundesh të falësh. Nuk kalon shumë që dikush të mos na lëndojë. Nganjëherë lehtë nganjëherë shumë thellë. Dashuria mund të na japë fuqi për të falur dhe kjo është një dhuratë e mrekullueshme që ia bëjmë tjetrit. Të jeni të gatshëm për të falur, mirëpo mos lejoni që të shfrytëzoheni. Nëse dikush nuk di të çmojë se Ju jeni duke ia falur



atij apo asaj, kjo ndoshta do t'ju dhemb.

G – Grindja

Mos keni frikë prej grindjeve! Grindja bën pjesë në shumicën e partneriteteve dhe mundet madje të jetë e mirë për një marrëdhënie. Konfliktet pra vetvetiu nuk janë të këqija, të paktën nëse përdoren për të vepruar në marrëdhënie, ato janë diçka pozitive. Gjeneri rrugë të grindeni në mënyrë konstruktive.

Gj – gjallëria (pasioni)

Shumë çifte e pyesin veten se si është e mundur që ta mbajnë gjallërinë në jetë edhe për shumë vite. Është e mundur edhe pse nuk është gjithmonë lehtë. Këtu vlen që Ju ta kuptoni veten si çift prej ku mund të lindë i gjithë pasioni. Ndoshta të provoni mënyra të ndryshme në marrëdhëniet Tuaja, ndoshta shikime, gjeste apo fjalë të caktuara, me të cilat te njëri-tjetri mund të nixtni dëshirën. Mirëpo, pasioni nuk lind me porosi dhe nën presion. Pasioni vjen nga thellësia dhe zbulohet, dhe, për fat, jo gjithmonë sa herë që ne dëshirojmë. Ta keni këtë para sysh dhe ta pranoni. Lejoni të ketë faza në të cilat ndoshta përjetoni më pak gjallëri. Fazat tjera do të pasojnë!

H – hapësirë veprimi

Çdo njeri ka nevojë edhe për një hapësirë të tij personale

krejt të lirë – dikush më shumë dikush më pak. Me kalimin e kohës, sipas fazave, mundet që kjo nevojë edhe të ndryshojë. Prandaj brenda një marrëdhënieje duhet pasur parasysh çdonjëri që veten mos ta lërë pas dore dhe të krijojë për vete një hapësirë të lirë të nevojshme. Vlen që këtë nevojë të tjetrit ta respektojë dhe jo që prej frikës nga humbja/largimi ta lidhim tjetrin për vetveten. Nëse tjetri kërkon pak distancë prej tjetrit, kjo nuk domethënë që ai apo ajo nuk e do më atë. Ndoshta ai apo ajo ka nevojë vetëm për një hapësirë të vogël, në mënyrë që sërish të mund të ju afrohet.

I – Imazhi (pamja e jashtme)

Shoqja jote i ka këmbët e shtrembra? Partneri Juaj i ka këmbët e mëdha? Njeriu i anës Tuaj është shumë i trashë apo shumë i hollë, shumë i vogël apo shumë i gjatë? Nuk do të duhej ta qortoni kurrë partnerin Tuaj apo partneren Tuaj për shkak dobësive apo mangësive të tija fizike. Askush prej nesh nuk është i përsosur. Ose e doni tjetrin ose jo. Disa njerëz ëndërrojnë për një ideal që nuk ekziston. Mendoni gjithmonë: Ju keni vendosur për këtë njeri, ashtu siç është. Përkrahni dhe mbani këtë qëndrim.

Si mundet varri i zbrazët të jetë argument i ringjalljes së Krishtit?

PËRGATITI:
Don Albert DEMAJ

Tek ringjallja e Krishtit shpesh dëgjojmë se si dija gra dhe nxënësit e gjetën varrin e zbrazët dhe petkat veçmas të palosura. Nganjëherë më duket se meshtarët varrin e zbrazët e shpjegojnë si argument të ngjalljes së Krishtit, që personalisht më duket i mangët apo tepër i vogël. Mendoj që argumentet duhet kërkuar diku tjetër, sepse varrin ka mundur ta zbrazët çdo kush tjetër? Si mendoni ju?

Lexusi juaj nga Prishtina

Nëse lindja e Krishtit në Betlehem ka qenë vepër e mrekulluar dhe unike e Shpirtit Shenjt, aq më tepër kjo vlen për ringjalljen e Tij. Për këtë arsye, shën Pali dhe apostujt tjerë jo pa arsye ringjalljen e konsiderojnë si esenciale për të dëshmuar hyjninë e Krishtit dhe mbinatyrshmërinë e besimit të krishterë. Mbi ngjalljen e Krishtit janë shkruara me qindra libra dhe komente biblike që në mënyrë të ndryshme merren me këtë ngjarje të mrekullueshme dhe të pa shpjegueshme, duke u nisur nga tekstet dhe duke iu dhënë kuptimin biblik, historik dhe teologjik.

Në shumë nga këta libra vëmendje të posaçme iu është kushtuar rrethanave dhe ngjarjeve që kanë ndodhur pas vdekjes së Krishtit dhe varrimit të tij, në hyrje të të cilit qitën gurin e madh, e mbi të cilin me kujdes të madh ruanin ushtarët romakë. Çdo kush që përdhunon varrin e vulosur me vulën romake, binte në kundërshtim me ligjin romak, dhe dënohej me vdekje bashkë

me rojet që kishin lejuar një gjë të tillë.

Varri i zbrazët

Nxënësit e Krishtit dëshmonin se Ai u është paraqitur gjatë një periudhe dyzetditëshe, duke u shfaqur me shumë prova bindëse. (Vap 1,3). Pali apostull thotë se Jezusi u është shfaqur me shumë se pesëqind vetëve në të njëjtën kohë, shumica prej të cilëve janë ende gjallë dhe mund ta vërtetonin se çka shkruante. (1 Kor 15, 3-8).

Varri i zbrazët ishte tepër i njohur për ta mohuar. Një dijetar thotë: Ringjalljen nuk kishin mundur ta pohonin në Jerusalemin për asnjë ditë, bile asnjë orë, nëse fakti i varrit të zbrazët nuk ishte i vendosur për të gjithë që kishin të bëjnë me çështjen.

Si mund ta sqarojmë varrin e zbrazët? Duke u bazuar në fakte bindëse të historisë, të krishterët besojnë se Krishti fizikisht është ngjallur në botën materiale me anë të fuqisë mbinatyrore të Hyjit. Vështirësitë e besimit janë të mëdha, po problemet thelbësore në mosbesim paraqesin vështirësi bile edhe më të mëdha. Teoritë e propozuara për të sqaruar ringjalljen nga shkaqet e rëndomta janë të dobëta. Në të vërtetë, ato ndihmojnë për të forcuar besimin për të vërtetën e ringjalljes.

Varri i gabuar?

Teorinë që e paraqesin disa se si gratë, që njoftuan se varri ishte i zbrazët, gabimisht kishin shkruar në një varr tjetër, nuk qëndron. Nëse është ashtu, atëherë nxënësit që shkuan për të vërtetuar fjalët e grave paskan shkruar në varr të gabuar?! Me-



gjithatë mund të jemi të sigurt se pushteti judeas që ishte mundur aq shumë për vrasjen e Krishtit, e që kishte kërkuar prej Pilatit që para varrit të vendosej roja romake që mos të vidhet kufoma, nuk do ta kishin gabuar vendin. As rojtaret romakë s'do të kishin gabuar sepse ata kanë qenë aty!

Në qoftë se problemi është te varri i gabuar, pushteti judeas shumë shpejt do ta kishte gjetur varrin e saktë bashkë me kufomën. Kështu ata do ta kishin shuar përgjithmonë pohimin e ringjalljes.

Vjedhja e kufomës

Një teori tjetër thotë se nxënësit e kanë vjedhur kufomën derisa rojtaret flinin. (Mt 28, 1-15). Depresioni dhe frika e apostujve nga vdekja e Krishtit (vetëvrasia e Judës, mohimi i Pjetrit) janë argument i fortë kundër kësaj teorie, se si nxënësit papritmas u bënë aq trima që të ballafaqohen me një aradhe ushtarësh romakë para varrit dhe ta vjedhin kufomën. Ishin 11-18 ushtarë romakë të përgatitur mirë ushtarakisht që ruanin varrin. Për çdo keqpërdorim të detyrës ushtarë dënoheshin me vdekje.

J.N.D. Anderson, dekan i fakultetit juridik në Londër, lidhur me këtë teori thotë, se ajo që thamë më lartë do të ishte në kundërshtim me krejt çka dimë për apostujt, mësimin e tyre mbi moralin, kualitetin e jetës së tyre, qëndrueshmërinë e tyre dramatike prej njerëzve të brengosur dhe dezertuesve të

dëshpëruar në dëshmitarë që askush nuk mund t'i ndalë.

Teoria se pushteti judeas ose romak e kishte zhvendosur kufomën e Krishtit, nuk është shpjegim më i arsyeshëm se shpjegimi për vjedhjen e kufomës nga ana e apostujve. Po ta kishte pushteti kufomën ose po ta dinte ku është, pse ata kur apostujt predikonin ringjalljen e Krishtit dhe i akuzonin pushtetarët për vdekjen e Krishtit, nuk thoshin: Pritni! Ne e kemi zhvendosur kufomën. Krishti nuk është ngritur nga varri! Po të mos kishin besuar njerëzit këtë kundërshtim, pse autoritet nuk e kanë shpjeguar saktësisht se ku është kufoma e Krishtit? Nëse njerëzit ende nuk kanë besuar, pse nuk e kanë marrë kufomën, ta vendosin në një qerre dhe të sillëshin rrugëve të Jerusalemit? Një veprim i tillë sigurisht do ta shkatërronte krishterimin.

Dr J U Mongomeri shton se si kalohen të gjithë kufijtë e besueshmërisë, se të krishterët e parë mund ta trillonin një përrallë të tillë dhe pastaj të predikonin atë në mesin e atyre që lehtë kanë mundur t'i përgënjeshtrojnë duke u paraqitur kufomën e Krishtit.

Të dhënat për ringjalljen

Tomas Arnold, kryetar i historisë moderne në Oxford, autor i i veprës në tri vëllime *Historia e Romës*, shkruan se si shumë vjet ka studiuar ndodhitë historike në kohëra të ndryshme, i ka shqyrtuar gjatë shkrimet dhe analizat e këtyre ngjarjeve,

por ai nuk e di në historinë e njerëzimit asnjë fakt më të mirë dhe që ka të dhëna më të plota se sa është shenja që na e dha Hyji kur Krishti ka vdekur dhe është ngjallur nga të vdekurit.

Dr Pal L Majer, profesor i historisë antike në Miçigen (SHBA), nxjerr përfundimin se duke peshuar të gjitha të dhënat me kujdes e me drejtësi, me plot arsye sipas rregullave të hulumtimit historik mund të përfundojmë se varri në të cilin që varrosur Krishti ishte i zbrazët në mëngjesin e parë të Ringjalljes. Gjithashtu asnjë dëshmi nuk është zbuluar deri tani në burime letrare, mbishkrime apo arkeologji për ta përgënjeshtruar këtë të vërtetë të Ungjillit.

Jeta e shndërruar e apostujve

Vërtet që ringjallja si akt i tillë nuk ka dëshmitarë. As rojtaret, të cilët flinin, nuk e kishin parë atë që kishte ndodhur. Në mesin e ihtarëve dhe nxënësve të Krishtit, sipas Mateut ungjilltar, gratë ishin të parat që kishin ardhur te varri dhe e gjetën atë të zbrazët.

Por, varri i zbrazët vetvetiu nuk është argument për besimin në ringjallje. Besimi në ringjallje nuk bazohet në varrin e zbrazët, por në dëftimin e Zotit dhe dëshminë e apostujve dhe të tjerëve që u takuan me Krishtin e ringjallur. Varri i zbrazët është shenjë që shndrit mbi lajmërimet e ngjalljes dhe të takimeve apo dëftimeve të Krishtit të ringjallur me apostujt.





Mateu saktë shkruan se si engjëlli ulajmëroigrares Krishti është ngjallur. Pra, dëshmia më bindëse për ringjalljen e Krishtit është nga Qielli por edhe vet jeta e apostujve dhe të krishterëve që të shkojnë kudo për të predikuar Krishtin e ngjallur. Po të kishin nxjerrë apostujt përfitime të ndryshme nga persekutimi duke dëshmuar ringjalljen e Krishtit si psh pasuri, pushtet etj, do të kishim arsyetuar veprimet e tyre, besnikërinë dhe dashurinë ndaj Krishtit të ringjallur. Por, siç e dimë, shpërblimi i apostujve dhe atyre që dëgjonin mësimet e tyre mbi ringjalljen e Krishtit ishte rrahja, vrasja me gur, kryqëzimet e torturat e ndryshme çnjerëzore. Nuk kishte mjet që nuk kishin përdorur pushtetarët për t'i ndaluar apostujt që mos të predikonin Krishtin e Ringjallur. Megjithatë, apostujt nuk i urrenin armiqët e vet, nuk i nxitnin as miqtë që t'i urrenin kundërshtarët. Apostujt të mësuar nga Krishti ishin paqdashës, të lumtur pse vuanin për shkak të emrit të Krishtit, askënd nuk e detyronin me forcë që të besonin në mësimin e tyre. Pra, dëshmia më e madhe se varri i Krishtit ishte i zbrazët, sepse Ai u ringjall, është jeta e ndershme, besnike, morale e apostujve të cilët të bindur në këtë të vërtetë vdiqën me vdekje martire duke besuar, predikuar dhe vdekur për Krishtin e Ringjallur. Le ta përkujtojmë me këtë rast Tomën apostull, sa vështirë e kishte të besonte në ringjallje. Por kur ai u bind, nuk u frikua si Juda, por predikoi dhe u martirizua duke dëshmuar Krishtin e ringjallur.

Para këtij lajmi të vet Fjalës


së Hyjit nuk mund të mbesim neutral as 2000 vjet pas kësaj ngjarje. Lajmërimi i engjëllit është bërë themel i besimit i Kishës së parë dhe i shekujve në vazhdim në të cilin besim martirët e shumtë e dhanë jetën, ndërsa shenjtërit dhe besimtarët tjerë, në mesin e tyre edhe ne shqiptarët, me jetë dhe me vepra ndërtojmë Kishën e Krishtit duke predikuar lajmin mbi shëlbimin dhe ringjalljen e të vdekurve të njerëzimit. Takimi me Krishtin, si ai i Marisë Magdalenë dhe i apostujve, dëshmia e tyre mbi këto takime janë themeli i besimit tonë.

Sot besimtari i Krishtit mund të jetë i sigurt se besimi i tij, sikur i të krishterëve të parë, nuk bazohet në mite, as në legjendë, por në të dhënat historike për Krishtin e ringjallur dhe varrin e zbrazët. Edhe sot besimtari mund të përjetojë fuqinë e Krishtit të ringjallur në jetën e tij. Besimtari e di se i janë falur mëkatet, i është siguruar jeta e amshuar dhe ringjallja nga varri. Besimtari me anë të ringjalljes së Krishtit mund të lirohet nga jeta e pakuptimtë dhe e zbrazët dhe mund të shndërrohet në një qenie të re nëpër Jezu Krishtin.

Ringjalljen e Krishtit nuk guxojmë ta përkujtojmë si një ngjarje që ka ndodhur para 2000 viteve, apo vetëm si festën më të madhe fetare pa të cilën nuk ka kuptim asnjë festë tjetër. Në aspektin shpirtërorë duhet ta përjetojmë çdo ditë ringjalljen e Krishtit. Andaj, forca e Krishtit të ringjallur qoftë frymëzimi ynë dhe fuqi shpirtërore për të dëshmuar dhe jetuar Krishtin e Ringjallur.

Dy lojëra për fëmijë

Jo...! Kështu nuk mund t'i leni këta vagabondë, gjeni së pari 10 ndryshime pastaj bashkoni yjet prej 1 deri në 50 dhe do të shihni se çfarë kanë të veshur.



Në këtë figurë 8-drejtimshe gjenden disa emra të lidhur me jetën e shën Palit. Shpresojmë se do t'i gjeni pa vështirësi – kuptohet: duke lexuar në të gjitha drejtimet! Ato emra janë: DAMASKU, QIPRO, TARS, ROMË, ILIRIK, BARNABA.

G	P	J	E	T	R	I	T
D	A	M	A	S	K	U	A
O	R	P	I	Q	E	A	R
L	A	T	I	T	I	T	S
J	A	K	O	B	I	T	S
A	Ë	M	O	R	I	S	R
E	I	L	I	R	I	K	A
T	B	A	R	N	A	B	T

Në të njëjtën tabelë janë fshehur edhe emrat e dy letrave të Shën Palit – pra Letra e Shën Palit, e drejtuar: dhe

Detyra juaj është që t'i gjeni dhe emrat e tyre t'i dërgoni në e-mail adresë: revistadrita@yahoo.com, ose t'i jepni mësuesit tuaj të fesë (meshtarit, apo motrës).



Ti që e do Nënë Terezën dhe ndërtimin e Katedrales, uroje, ndihmoje, realizoje, duke thirrur në numrin

0900-901-101

Çdo thirrje e jote të kushton një euro.

TA NDIHMOJMË NDËRTIMIN E KATEDRALES

*Jam mik i Kishës Katolike
dhe dua ta ndihmoj
ndërtimin e Katedrales
"Nëna Terezë" në Prishtinë!*

Gjithë juve miq dhe bami­rës të dashur, ju mundësojmë ta jepni kontributin përmes xhirolloqarive bankare.

Faleminderit!



Raiffeisen BANK
Kosovo J.S.C.
ntina, Kosovo
FT code: RBKORS22

Adm. Ap. e Prizrenit
Numri i llogarisë:

EUR: 1501 090000 1990 20
USD: 1501 090000 3765 30
CHF: 1501 090000 3764 33

Valuta	Banka	Shteti	SWIFT/BIC
EUR	Raiffeisen Zentralbank Oesterreich AG	Vienna, Austria	RZBAATWW
USD	American Express Bank, LTD	New York, US	AEIBUS33
CHF	UBS AG	Zurich, CH	UBSWCHZH80A

ABONONI "DRITËN"

Tash mund të jeni abonues të revistës kulturore të Kishës Katolike në Kosovë "*Drita*". Për vetëm 12 euro në vit (ose 1 euro për secilin numër), ne do t'ju dërgojmë **me postë** "*Dritën*" (vetëm brenda territorit të Kosovës).

Plotësoni formularin e mëposhtëm, dhe na e dërgoni bashkë me vërtetimin e pagesës në adresën tonë: **Rr. Gjon Pali II 1, 20000 Prizren.**

Emri: _____

Mbiemri: _____

Adresa: _____

Qyteti: _____

Kodi postar: _____

Numri i telefonit: _____

E-mail: _____

Pagesa prej 12 eurosh mund të deponohet në Raiffeisen Bank Kosovo, në llogarinë 1502 0310 0086 0188. Ju lutemi, mos harroni ta futni fletëdeponimin në zarf bashkë me këtë formular. Ju faleminderit!

Për informata më të hollësishme, ju lutemi të na kontaktoni në numrin e telefonit: 029 241 933/14, me faks: 029 241 232 ose me email: revistadrita@hotmail.com ose revistadrita@yahoo.com.



DRITA

“Drita lufton kundër errësirës kur ndriçon.”

E PËRMUAJSHME FETARE - KULTURORE E KISHËS KATOLIKE
Prizren • Mars 2009 • Viti XXVI • Nr. 3 (173) • Çmimi: Kosovë 16, Europë 26, Zvicër 35SR, SHBA \$2.50



**JAVA E MADHE DHE
KREMTIMI LITURGJII
I SAJ**

FAQE 10-11

Shikruar:
DON AGIM QERKINI



**ZËRI I MISIONIT
ZË I ARSYES**

FAQE 6

**Shkruan:
LEKË PREÇI**



Porosia e ipeshkvit për Pashkët 2009

Moshartëre, rregullartëre dhe rregullartëre, besimtarëre katolikë si dhe të gjithë njerëzve vullnetmori

Pas një periudhe të gjatë katërdhënditore të kohës së Krushëve, në të cilën na u dha mundësia, që, përmes lutjes, agjërimit dhe barmirës, të përgatitnim menjëherë tonë shpirtëror për takimin me të Ringjallur, tani në festën e madhe të Pashkëve dëshiroj të bëhem jehonë e atij zëri të gëzimit dhe të shpresës, i cili na thotë: *"Ju mua u trembën! E di se kërkoni Jezusin e kryqëzuar! Ai nuk është kurrë! U ngrat sikur të Eja!"*

[illegible]

Ese:
Eutanazia
e panënskruar

FAQE 15

Shkruan:
Pol CANAI

**Një jetë me peripeci,
por edhe me fe dhe
shpresë në Zotin**

[illegible]



Viti V, Nr. 56, Maj 2009

Jeta Liturgjike

**E Diela e Bariut të Mirë
- Dita e lutjes për thirrje meshtarake**



E Diela e III E PASHKËVE

Leximi i parë Vap 3, 13-15.17-19

Pjetri, pasi ka shëruar të paralizuarin që kërkonte lëmoshë në hyrjen e tempullit, shpall ringjalljen e Krishtit. Kjo mrekulli është prova që Jezusi nuk ka vdekur përfundimisht, por vazhdon veprën e tij në një mënyrë të re mes njerëzve. Ai është ringjallur, dhe apostujt janë dëshmitarët. Është akoma e mundur të njohim të Gjallin dhe ta ndjekim.

Psalmi 4

Le të shndrisë mbi ne, o Zot, drita e fytyrës sate

Leximi i dytë 1 Gjn 2, 1-5

Të duash një person do të thotë të pranosh në vetvete dobësinë e tij: Jezusi është vendosur nga ana e të akuzuarve. Të duash do të thotë të shndërrosh jetën tënde në funksion të nevojave të të tjerëve. Dashuria që unë provoj për Jezusin do të jetë e vërtetë vetëm nëse zbatoj urdhërimet e tij. Vetëm kështu do të mund të shfaq besnikërinë time konkrete.

Ungjilli Lk 24, 35-48

Në atë kohë, pasi që u kthyen nga Emausi, dy nxënësit u treguan çka u ngjau udhës dhe si e njohën kur e ndau bukën. Ndërsa këta ende po bisedonin për këto ngjarje, vetë Jezusi zuri vend në midis të tyre dhe tha: "Paqja me ju!" Të tmerruar dhe të frikësuar, mendonin se po shihnin ndonjë shpirt. Jezusi u tha: "Pse po trembeni? Pse po dyshoni në zemrat tuaja? Shikoni duart e mia e këmbët e mia: unë jam! Vetë. Më prekni e vërtetoheni! Shpirti s'ka mish e eshtra, si po shihni se unë kam!" Si u tha kështu, u dëftoi duart e këmbët. Pasi ata, prej gëzimit nuk mundën të besojnë, por kishin mbetur të habitur, Jezusi u tha: "A keni këtu ndonjë gjë për të ngrënë?" Ata i sollën një kurm peshku të pjekur. Jezusi e mori dhe e hëngri para tyre.

Atëherë u tha: "Këtë veshtrim kishin fjalët që ju thosha kur ende isha me ju: 'Duhet të shkojë në vend gjithçka u shkrua për mua në Ligjin e Moisiut, në Profetët e në Psalme.' Atëherë ua shndriti mendjen që t'i kuptonin Shkrimet dhe u tha: 'Kështu është në Shkrim shenjt: 'Mesia i duhet të pësojë e të ngjallet së vdekuri të tretën ditë'. Në Emër të tij do të predikohet ndër të gjithë popujt, duke filluar prej Jerusalemit, kthimi dhe falja e mëkateve. Ju jeni dëshmitarët e kësaj gjëje.'

Fjala e Zotit

Paqja me ju! Këto fjalë të Jezusit të ringjallur për paqen mund të përsëriten në jetën tonë. Na flasin kur i ekspozohemi brengosjeve dhe frikësimeve. Nxënësit i dëgjuan në shumë situata dhe i mbajtën në mend këto fjalë: Unë jam, mos kini frikë! janë fjalët që Jezusi na i shqipton edhe ne, në çdo kohë.

Kështu kemi rastin e Tomës së guximshëm dhe apostullit të sinqertë, i cili pas vdekjes së Jezusit përjetonte mërzinë dhe dhimbjen në mënyrën e tij, kështu që e kishte lëshuar takimin e parë me Zotërinë. Mund të hyjë

në ndjenjat e tij dhe ta përjetojë izolimin e kundërshtimit e tij në shprehjen e tij: *Pa e parë dhe pa e prekur nuk besoj!* Të njëjtën vuajtje e përjetoj çdo herë kur largohem dhe izolohehem nga bashkësia e besimtarëve. Shoqëria e miqve më duhet më së shumti atëherë kur jam aq i lodhur nga pikëllimi. Në pozitë të ngjashme qenë edhe nxënësit e dëshpëruar që po ktheheshin në Emaus, në jetën e tyre të mëparshme. Ishin izoluar në mendimet dhe pritjet e tyre për Shpëtimtarin e botës. Por edhe të gjithë apostujt të ngjuar në dhomë, me dyer të mbyllura, i përngjanin një grigje të frikësuar që priste intervenimin e Zotit për t'i çliruar. Gjatë kohës sa ishte me nxënësit e vet, veçanërisht pas ringjalljes, Jezusi vazhdimisht përsëriste: *Mos kini frikë! Unë jam! Ose: Mos druani! Unë jam me ju të gjitha ditët deri në të sosur të botës!* Këtë ma porositi Jezusi edhe tani: *Mos ke frikë! Unë jam me ty, kur jam unë me ty, nuk ka vend për frikë! A besoj në këtë?*

Çdo tryezë eukaristike është Emaus, takim me Jezusin e ringjallur, çdoherë kur e dëgjojmë Shkrimin shenjt është rruga që çon për Emaus. Gjithmonë jemi në rrugë kur flet Jezusi dhe kur e thyen bukën e dashurisë së tij. Fjala i jep kuptim jetës sonë si dhe interpretimi i tij i Shkrimit shenjt apostujve; buka e jetës na ushqen sikurse Jezusi pranë tryezës u dha të hanë apostujve. Fjala dhe buka i kthyen sërish nxënësit në bashkësi dhe apostujt i dërguan në botë me përvojën se si e takuan dhe e njohën. Fjala dhe buka e përditshme mund ta bëjnë këtë gjë edhe për ne.

Jezusi, para se apostujt ta përjetonin ringjalljen, i kishte porositur të gjithë që të shkojnë në Galile e atje do ta shohin. Të njëjtën thirrje na e drejton neve. Galileja jonë mund të jetë familja, fqinjësia, hapësira për lutje, njerëzit që janë në nevojë për ndihmë... çdo moment kur bëhemi të vetëdijshëm për afërsinë e Jezusit. Kjo ndodh në lutje, e cila e rrit vetëdijen dhe vigjilencën tonë. Të të bie ndër mend kur ka qenë Zoti afër teje dhe ji mirënjohës. Lejoji Zotit që të të thotë: *shko dhe shih* – shko në familjen tënde, në punën tënde, në lutjen tënde, në të përditshmen tënde, atje do të më gesh.

Lutjen mund ta krahasojmë me kohën në të cilën i çelemi dritës së Zotit, si atëherë kur shtrihemi nën diell dhe rrezitemi, në dritën që na ndriçon plotësisht. Drita e Zotit në lutje krejtësisht hyn në personin në mënyrën që i lehtëson barrët e jetës dhe na jep zemër që këtë dritë që ringjall ta ndajmë me të tjerët. Në lutje mund të na ndihmojë që ta paramendojmë dritën që na rrethon por edhe që kjo dritë është rreth nesh edhe kur nuk lusim.

Çdo herë kur bashkëndiejmë, kur veprojmë për realizimin e pajtimit, besimit, drejtësisë dhe paqes, si dhe kur i japim njëri-tjetrit zemër për të qenë popull i shpresës, ne jemi popull i ringjalljes dhe shërbëtorët e ringjalljes. Jezusi ngrihet prej së vdekuri çdo herë kur jetojmë mënyrën e tij të jetës. Këtë e bëjmë në mënyra të ndryshme duke e treguar kujdesin për jetët dhe nevojat e të tjerëve. Kur jemi duke medituat se si mundemi më së miri t'i shërbejmë Zotit të ringjallur, sot kemi mundësi të lusim që të jemi shërbëtorët e ringjalljes dhe bartësit e shpresës dhe optimizmit të Pashkëve.

Zoti e di emrin tim dhe e njeh trupin tim. Fytyra ime

është vazhdimisht para tij, fytyra të cilën e ka formësuar historia e jetës, fytyra që shpreh dashurinë, kënaqësinë, vuajtjen, humorin dhe butësinë. Më mëso ta dua fytyrën dhe trupin tim, tempullin tim të Shpirtit Shenjt. Trupi im është i shenjtë, për këtë na vetëdijëson Ringjallja dhe më hap dhe tregon një shikim të mistershëm dhe të pakufi. Në plakje e sipër asgjë nuk na jep aq shumë kuptim sa vuajtja dhe ringjallja, siguria që edhe trupi ynë, sikurse i Jezusit, do të vuajë dhe të vdesë, mirëpo edhe siguria që, në trupat tanë, na pret jeta pas vdekjes - ringjallja.

Lutja e besimtarëve

O Zot, Jezu Krisht, vazhdimisht u je zbuluar nxënësve tu. Na u dëfto edhe ne dhe të gjithë njerëzve që kanë nevojë.

- Për të gjithë ata që kanë përgjegjësi në Kishë, që Lajmin tënd të Gëzueshëm edhe sot t'ua kumtojnë njerëzve: bëj që fjalën tënde dhe takimin me ty ta përjetojnë thellë në brendi, *të lutemi.*
- Për të gjithë ata që bartin përgjegjësi të vështira në situatën ekonomike për shumë punëdhënës: jepu shpirtin tënd që të gjejnë zgjidhje, *të lutemi.*
- Për bashkësitë tona, në të cilat si të krishterë kërkojmë qëndrueshmëri dhe marrëdhënie të shëndosha: hapi zemrat tona për njëri-tjetrin dhe për ty, *të lutemi.*
- Për familjet tona, në të cilat ngarkesat e mëdha e kanë bërë jetën e përbashkët të vështirë: jepu shoqërues që do t'i mbështesin në vështirësitë e tyre, *të lutemi.*
- Për të sëmuret tanë dhe ata që vuajnë: zbuloju në mënyrë të re fjalën tënde, që ta përjetojnë kuptimin dhe ngushëllimin, *të lutemi.*

O Zot, Jezu Krisht, ti na e ke zbuluar jetën e re. Ty të qoftë lavdi e ndera, sot e përgjithmonë e jetës. Amen.

P. Shtjefën Dodes SJ

E Diela e IV e Pashkëve - Unë jam Bariu i mirë

Leximi i parë Vap 4, 8-12

Mrekullia e kryer nga Pjetri dhe Gjoni duke shëruar të paralizuarin, është shenjë e fuqisë së Jezusit, ai Jezu që autoritetet fetare e kanë kryqëzuar dhe që Hyji Atë e ka ringjallur. Mrekullia është prova se Jezusi është gjallë dhe që kohërat e fundit kanë filluar: do të thotë koha e kishës. Pjetri fillon predikimin e emrit të Zotit Jezus: kush beson në emrin e tij beson se fitorja e tij mbi vdekjen dhe mëkatin vazhdon akoma edhe sot. Kush është i pagëzuar bashkëpunon sot me Krishtin për shpëtimin e çdo njeriu.

Psalmi 118 Guri i qitur jashtë përdorimit, u bë gur i këndit

Leximi i dytë 1 Gjn 3, 1-2

Ringjallja e Krishtit nuk është për të gjithë, por vetëm për ata që besojnë. Ata që refuzojnë t'i besojnë Krishtit, mbyllën ndaj mundësisë për të njohur jetën e Hyjit të pranishme te besimtarët. Hyji na ka dashur aq shumë, sa që mund të quhemi bijtë e tij dhe ka shpërndarë në qenien tonë bamirësinë e tij prej Ati. Nëse me të vërtetë jetojmë si bij të Hyjit dëshmojmë dashurinë e Atit dhe i ftojmë të tjerë ta njohin.

Ungjilli Gjn 10, 11-18

Në atë kohë, Jezusi tha: *"Unë jam Bariu i mirë. Bariu i mirë e jep jetën e vet për dele. Rrogëtari, - që s'është bari, të cilit nuk i përkasin dhentë - kur sheh se po vjen ujku, lë dhentë e ikën - e ujku i rrëmben dhe i shpërndan: është rrogëtar dhe s'është në kujdes për dhen.*

Unë jam Bariu i mirë: i njoh të miat dhe ato më njohin mua. Sikurse Ati më njeh mua dhe unë e njoh Atin edhe jetën e jap për dele. Kam edhe tjera dele, që nuk janë të kësaj vathe. Edhe ato më duhet t'i bashkoj dhe do ta dëgjojnë zërin tim, do të bëhet një grigjë e vetme e një Bari i vetëm. Prandaj edhe më do Ati, sepse e jap jetën time që ta marr përsëri. Askush nuk mund të ma marrë: por unë e jap prej vetes. Kam pushtet ta jap jetën e kam pushtet ta kthej prapë atë. Këtë urdhër e mora prej Atit tim."

Fjala e Zotit

Me rastin e Ditës Botërore të lutjes për thirrjet në meshtari dhe në jetën e përkushtuar që do të kremtohet më 3 maj 2009, në të Dielën e katërt të Pashkës, me ëndje ftoj mbarë popullin e Hyjit që të reflektojë mbi temën: *Besimi në nismën e Hyjit dhe përgjigjja njerëzore.* Kumbon e përjetshme në Kishë thirrja e Jezusit drejtuar dishepujve



të vet: *Lutjuni, pra Zotërisë së të korrave, të dërgojë korratarë në të korrat e veta (Mt 9, 38)*. Lutuni! Thirrja e ngutshme e Zotit nënvizon se si lutja për thirrjet duhet të jetë e pandërprerë dhe besimplotë. Në fakt, vetëm nëse është e gjallëruar nga lutja, bashkësia e krishterë mundet vërtet që të ketë më shumë besim dhe shpresë në nismën hyjnore

Thirrja në meshtari dhe në jetën e përkushtuar, është një dhuratë e veçantë hyjnore që ndërfitet në planin e gjerë të dashurisë dhe të shpëtimit që Hyji ka për çdo njeri dhe për mbarë njerëzimin. Pali apostull, të cilin e kujtojmë në mënyrë të posaçme gjatë këtij viti kushtuar atij në dymijë vjetorin e lindjes së tij, duke u shkruar efesianëve pohon: *Qoftë bekuar Hyji, Ati i Zotit tonë Jezu Krishtit, i cili na bekoj me çdo bekim shpirtëror në qiell në Krishtin...* (Ef 1, 3-4). Në thirrjen e gjithëmbarshe ndaj shenjtërisë del në pah nisma e veçantë e Hyjit, me anë të së cilës zgjedh disa që ta ndjekin më nga pranë Birin e tij Jezu Krishtin, dhe për të qenë shërbetarë e dëshmitarë të tij të privilegjuar. Mësuesi hyjnor i thirrri personalisht Apostujt që të jenë me të e t'i dërgojë të predikojnë, e ta kenë pushtetin t'i dëbojnë djajtë (Mk 3, 14-15); ata, nga ana e tyre, u bashkuan me dishepuj të tjerë, bashkëpunëtorë besnikë në shërbesën misionare. Dhe në këtë mënyrë, duke iu përgjigjur thirrjes së Zotit dhe të përkulshëm ndaj veprimit të Shpirtit Shenjt, aradhe të panumërta priftërinjsh dhe personash të përkushtuar, gjatë shekujve në Kishë, e kanë vendosur veten në shërbim të plotë të Ungjillit. I falemi nderit Zotit që edhe sot vazhdon të thërrasë punëtorë për vreshtin e vet. Edhe pse është e vërtetë që në disa zona të botës ka një mungesë shqetësuese priftërinjsh, dhe që vështirësitë dhe pengesat e shoqërojnë ecjen e Kishës, na mbështet siguria e patundshme që në rrugët e kohës drejt përmbytjes përfundimtare të Mbretërisë së udhëheq Ai, Zoti, që me liri zgjedh dhe fton ta ndjekin persona nga çdo kulturë dhe moshë, sipas planeve të pashqyrtueshme të dashurisë së tij të mëshirshme.

Pra detyra jonë e parë është ta mbajmë gjallë, me lutje të paprerë, këtë thirrje të nismës hyjnore në familje dhe në famulli, në lëvizjet dhe në shoqatat e angazhuara në apostullim, në bashkësitë rregulltare dhe në të gjitha shtjellimet e jetës dioqezane. Duhet të lutemi që mbarë populli i krishterë të lutet në besimin tek Hyji, i bindur se i zoti i të korrave nuk rresht së kërkuari nga disa që ta angazhojnë lirisht ekzistencën e tyre për të bashkëpunuar me të më nga afër në veprën e shpëtimit. Dhe nga ana e atyre që janë të thirrur kërkohet një dëgjim i vëmendshëm dhe një shoshitje e kujdesshme, pjesëmarrje bujare dhe e menjëhershme ndaj planit hyjnor, një përthellim serioz i asaj çka i përket thirrjes meshtarake dhe rregulltare për t'iu përgjigjur në mënyrë të përgjegjshme dhe të bindur. *Katekizmi i Kishës Katolike* kujton me vend se nisma e lirë e Hyjit kërkon përgjigjen e lirë të njeriut. Një përgjigje pozitive që presupozon gjithmonë pranimin dhe bashkëndarjen e planit që Hyji ka për secilin; një përgjigje që e pranon nismën e dashurisë së Zotit dhe bëhet për atë që është i thirrur një nevojë morale shtrënguese, një nderim mirënjohës ndaj Hyjit dhe një bashkëpunim tërësor me planin që Ai përmbyt në histori (krah nr. 2062).



Duke kundruar misterin eukaristik, që shpreh në mënyrën më të plotë dhuratën e lirë që bën Ati në Personin e Birit të Njëlindur për shpëtimin e njerëzve, dhe gatishmërinë e plotë dhe të bindur të Krishtit për ta pirë deri në fund *kelkun* e vullnetit të Hyjit (krah Mt 26, 39), kuptojmë më mirë se *besimi në nismën e Hyjit* formëson dhe i jep vlerë *përgjigjes njerëzore*. Në Eukaristi, dhurata e përkryer që realizon planin e dashurisë për shëlbimin e botës, Jezusi flijohet lirisht për shpëtimin e njerëzimit. Kisha – ka shkruar paraardhësi im i dashur Gjon Pali II – e ka marrë Eukaristinë nga Krishti Zoti i saj – jo si një dhuratë, edhe pse e çmuar mes shumë të tjerash, por si *dhuratën e shkëlqyer*, sepse është dhuratë e vetvetes, e personit të tij, në njerëzimin e tij të shenjtë, si dhe e veprës së tij të shpëtimit (Enc. *Ecclesia de Eucharistia*, 11).

Priftërinjtë, që pikërisht në Krishtin eukaristik mund të kundrojnë modelin e rrallë të një “dialogu thirrës” mes nismës së lirë të Atit dhe përgjigjes besimplotë të Krishtit, kanë detyrën për ta përjetësuar këtë mister shpëtimsjellës në shekuj, deri në kthimin e lavdishëm të Zotit. Në kremtimin eukaristik është vetë Krishti që vepron tek ata që Ai zgjedh si meshtarë të tij; i mbështet që përgjigjja e tyre të zhvillohet në një përmasë të besimit dhe mirënjohjes që fshin çdo frikë, edhe kur bëhet më e fortë përvoja e dobësisë vetjake (khs Rom 8, 26-30), apo

bëhet më i ashpër konteksti i moskuptimit apo deri edhe i përndjekjes (khs *Rom* 8, 35-39).

Vetëdija se jemi shpëtuar nga dashuria e Krishtit, që çdo Meshë e Shenjtë ushqen tek besimtarët dhe veçanërisht tek priftërinjtë, nuk mund të mos nxisë në ta një braktisje besimplotë në Krishtin që ka dhënë jetën për ne. Besimi tek Zoti dhe pranimit i dhuratës së tij, të çon në besimin ndaj Tij me shpirt mirënjohës duke marrë pjesë në planin e tij shpëtimsjellës. Nëse kjo ndodh, “i shpëtuari” braktis me shumë dëshirë gjithçka dhe ulet në bankat e shkollës së Mësuesit hyjnor; atëherë nis një dialog pjellor mes Hyjit dhe njeriut, një takim i mistershëm mes dashurisë së Zotit që thërret dhe lirisë së njeriut që në dashuri i përgjigjet, duke dëgjuar t’i kumbojnë në shpirt fjalët e Jezusit: “Ju nuk më zgjodhët mua, por unë ju zgjodha ju dhe ju caktova të shkoni e të jepni fryt e fryti juaj të qëndrojnë” (*Gjn* 15, 16).

Ky gërshetim dashurie mes nismës hyjnore dhe përgjigjes njerëzore është i pranishëm, në mënyrë të admirueshme, edhe në thirrjen për jetën e përkushtuar. Na kujton Konkili II i Vatikanit: “Këshillat ungjillore të dëlirësisë së përkushtuar Hyjit, të varfërisë dhe të bindjes, pasi që janë të bazuara në fjalët dhe shembujt e Zotit, dhe na janë porositur nga Apostujt, nga Etërit, nga doktorët dhe nga barinjët e Kishës, janë një dhuratë hyjnore, që Kisha ka marrë nga Zoti i saj dhe me hirin e tij i ruan gjithmonë” (kusht. *Lumen gentium*, 43). Akoma edhe një herë, është Jezusi modeli shembullor i pjesëmarrjes tërësore dhe besimplotë ndaj vullnetit të Atit, që duhet të shohë çdo person i përkushtuar. Të tërhequr prej tij, që në shekujt e parë të krishterimit, shumë burra dhe gra kanë braktisur familjen, pronat, pasuritë materiale dhe gjithçka që njerëzisht mund të dëshirohet, për të ndjekur bujarisht Krishtin dhe për të jetuar pa kompromise Ungjillin e tij, që për ta është bërë shkollë e shenjtërisë rrënjësore. Edhe sot shumë vetë e përshkojnë të njëjtin itinerar kërkues të përsosmërisë ungjillore, dhe e realizojnë thirrjen e tyre me shpalljen e këshillave ungjillore. Dëshmia e këtyre vëllezërve e motrave tona, në manastiret e jetës kundruese si edhe në institutet dhe kongregatat e jetës apostolike, i kujton popullit të Hyjit “misterin e Mbretërisë së Hyjit që vepron në histori, por që pret realizimin e plotë në qiej” (Thirrja ap. postsinodale Jeta e përkushtuar, 1).

Kush mund të ndihet i denjë për t’iu afuar meshtarisë? Kush mund ta përqafojë jetën e përkushtuar duke u mbështetur thjesht në burimet e veta njerëzore? Akoma edhe një herë, është me dobi të theksojmë se përgjigjja e njeriut ndaj thirrjes hyjnore, kur jemi të vetëdijshëm se është Hyji ai që e ndërmerr nismën dhe është sërish ai që e përfundon planin e tij shpëtimsjellës, nuk vishet kurrë me llogarinë e ndrojtur të shërbëtorit përtac që nga frika e fshehu nën dhë talentin që iu besua (khs *Mt* 25, 14-30), por shprehet në një pjesëmarrje të menjëhershme ndaj ftesës së Zotit, siç bëri Pjetri kur nuk ngurroi t’i hidhte sërish rrjetat edhe pse ishte mundur gjithë natën pa zënë asgjë, duke i besuar fjalës së tij (khs *Lk* 5, 5). Pa hequr aspak dorë nga përgjegjësia personale, përgjigjja e lirë e njeriut ndaj Hyjit bëhet në këtë mënyrë “bashkëpërgjegjësi”,

përgjegjësi në dhe me Krishtin, falë veprimit të Shpirtit të tij të Shenjtë; bëhet bashkim me Atë që na bën të aftë të japim shumë fryte (krah *Gjn* 15, 5).

Përgjigje njerëzore emblematike, plot me besim në nismën e Hyjit, është “Amen”-i bujar dhe i plotë i Virgjërës së Nazaretit, shqiptuar me pjesëmarrje të përvujtur dhe të vendosur ndaj planeve të Gjithë të Lartit, që Asaj iu përcollën nga lajmëtari qiellor (khs *Lk* 1, 38). “Po”-ja e saj e menjëhershme bëri të mundur që Ajo të bëhej Nëna e Hyjit, Nëna e Shpëtimtarit tonë. Marisë, pasi tha për herë të parë këtë “fiat”, shumë herë të tjera iu desh ta përsërisë, deri në çastin kulmor të kryqëzimit të Jezusit, kur *qëndronte pranë kryqit*, siç vë re ungjilltari Gjon, bashkëpjesëmarrëse e dhimbjes mizore të të Birit të pafajshëm. Dhe pikërisht nga kryqi, Jezusi duke vdekur na e ka dhënë si Nënë dhe na ka besuar tek Ajo si bij (krah *Gjn* 19, 26-27), Nënë posaçërisht e priftërinjve dhe e personave të përkushtuar. Asaj do të doja t’ia besojta ata që kuptojnë thirrjen e Hyjit për t’u vënë në udhë në rrugën e meshtarisë apo të jetës së përkushtuar.

Të dashur miq, mos t’ju lëshojë zemra përballë vështirësive dhe dyshimeve; besojini Hyjit dhe ndiqni besnikërisht Jezusin dhe do të jeni dëshmitarë të gëzimit që shpërthen nga bashkimi i thellë me Të. Duke imituar Virgjërën Mari, që brezat e shpallin të lumtur, sepse ka besuar (krah *Lk* 1, 48), angazhohuni me çdo energji shpirtërore për të realizuar planin shpëtimsjellës të Atit qiellor, duke kultivuar në zemrën tuaj, porsia Ajo, aftësinë për t’u habitur dhe për të adhuruar Atë që ka pushtetin për të bërë “gjëra të mëdha” sepse Shenjtë është emri i tij (krah *po aty* 1, 49).

Papa Benedikti XVI

Lutja e besimtarëve

Të drejtuar nga Jezusi, bari i mirë e të tërhequr prej tij në rrugën e shërbimit e të fjalës, ia lartësojmë me besim Atit lutjet tona, duke thënë: O Bari i përjetshëm, mbroji bijtë e tu.

- Që barinjte e Kishës të jenë me fjalë e me shembuj shenjë e gjallë e Krishtit, bari i mirë që jep jetën për grigjën e vet, *të lutemi*.

- Shpirti Shenjtë ngushëlloftë të gjithë ata që vuajnë për shkak të dhunës e të luftës, e të kthejë përgjegjësit e shteteve drejt krijimit të paqes, *të lutemi*.

- Që Shpirti Shenjtë frymëzojë në shumë të rinj dëshirën për të shkuar pas Krishtit, *të lutemi*.

- Për ne: që të angazhohemi gjithmonë e më shumë për të shkuar pas Krishtit si drejtuesi ynë dhe mësues i vërtetë e bari i vetëm i shpirtit tanë, *të lutemi*.

O Atë, që në shkollën e Krishtit Birit tënd, na mëson që të mos presim që të na shërbejnë të tjerët, por t’i shërbejmë ne vëllezërve. Na ndihmo që të ecim në këtë rrugë të përvujtërisë e të dashurisë, të palodhur në dhurimin e vetes sonë. Nëpër Krishtin Zotin tonë. Amen

E diela e V e Pashkëve

Leximi parë: Vap 9, 26 – 31.

Leximi i parë na paraqet Shën Palin apostull, i cili dëshiron të bëhet pjesë e nxënësve të Jezu Krishtit. Sikurse apostujt tjerë i tregonin njëri-tjetrit se e kanë parë Zotërinë e ringjallur, edhe Pali në një mënyrë krejt të veçantë tregon haptas se e ka parë dhe ka folur me Jezu Krishtin në rrugën e Damaskut. Apostujt kanë frika ta pranojnë Palin në bashkësinë e tyre sepse nuk besojnë krejtësisht në kthimin dhe bindjen e tij në Jezusin e Ringjallur. Pali edhe pse i kërcënuar me vdekje nga vëllezërit e tij hebrenj, ai nuk dëshiron të ndahet nga trupi mistik i Krishtit që është Kisha.

Psalmi: 22 (21)

Ty të lavdëroj, o Zot, në bashkësinë e vëllezërve.

Leximi i dytë: 1 Gjn 3, 18 – 24.

Në leximin e dytë Shën Gjoni apostull tregon qartas se dashuria e vërtetë për Zotin dhe për njeriun nuk qëndron në fjalë të bukura dhe të mira por në vepra dhe në të vërtetë. Nëse dëshirojmë ta dijmë se a jemi apo nuk jemi në rrugën dhe në të vërtetën e Zotit, duhet të ndalemi dhe të mendojmë: a u përngjajnë veprat tona veprave të Zotit. Dashuria në vepër është prova themelore e të qenit të krishterë.

Ungjilli: Gjn 15, 1-8.

Në atë kohë, Jezusi u tha nxënësve të vet: *Unë jam hardhia e vërtetë, e im Atë është vreshtari. Çdo shermend në mua, që nuk jep fryt, Ai e pret,*

kurse secilin që jep fryt, Ai e pastron, që të japë më shumë fryt.

Tashmë ju jeni të pastruar me anën e fjalës që ju thashë. Banoni në mua sikurse edhe unë në ju. Sikurse shermendi nuk mund të japë fryt

prej vetvetes, i shkëputur prej hardhisë, po ashtu as ju, nëse nuk mbeteni në mua. Unë jam hardhia, ju jeni shermendet.

Kush mbetet në mua e unë në të,

ai jep shumë fryt, sepse pa mua s'mund të bëni asgjë. Nëse ndokush nuk mbetet në mua, hidhet jashtë pors shermendi i prerë e thahet.

Të tillët i bashkojnë, i qesin në zjarr e digjen. Nëse mbeteni në mua,

dhe, nëse fjalët e mia qëndrojnë në ju, lypni gjithçka të doni dhe do t'ju jepet. Me këtë gjë lavdërohet im Atë: nëse jepni shumë fryt e dëftoheni nxënës të mi.

Fjala e Zotit

Ungjilli i kësaj të diele përmes shëmbëlltyrës të hardhisë dhe të shermendeve, dëshiron të vë në pah rëndësinë dhe suksesin e madh që mund të ketë njeriu kur është i bashkuar me Krishtin, dhe anasjelltas, humbjen dhe dështimin, nëse ndahet apo largohet nga Ai.

Të qëndrosh i bashkuar me Krishtin do të thotë ta pranosh hirin e Tij në vazhdimësi, sepse pa të nuk

mundemi asgjë. Urata, leximi, meditim, veprat e mëshirshme... janë mjete përmes të cilave njeriu mundet dhe duhet të qëndrojë i bashkuar me Hardhinë e vërtetë që është Krishti. Shermendet janë të caktuara të sjellin fryte, nëse nuk sjellin fryte prehen, treten dhe thahen. E njëjta gjë vlen edhe për ne: vetëm nëse mbetemi të bashkuar me Krishtin, mbetemi të gjallë dhe do të sjellim fryte të mëdha, përndryshe do të thahemi, vyshkemi.

Jezusi me një qartësi dhe dashuri të pamasë na thotë: *pa mua nuk mund të bëni asgjë.* Shumë herë mund të ngashënjehemi duke menduar se shumë gjëra mund të'i çojmë përpara të pavarur, me vetë fuqitë tona, pa ndihmën dhe përkrahjen e Zotit, por me kalimin e kohës kuptojmë dhe bindemi se vetvetja nuk na mjafton, kemi nevojë për Zotin dhe ndihmën e Tij.


Rreziku i kohës moderne, në të cilën jetojmë, është se njeriu i afrohet Zotit, apo bashkohet me të vetëm në disa raste të rënda apo të dhimbshme të jetës së tij, siç mund të jenë: sëmundja, vështirësitë e ndryshme të jetës, katastrofat e ndryshme natyrore, luftërat, vdekja...! Nuk është e mundur që një shermend të qëndrojë i shëndoshë, e aq ma pak të sjellë fryte, nëse mbetet i bashkuar me hardhinë e vetë vetëm në disa momente të jetës së vet. E njëjta gjë ndodh edhe me jetën e njeriut, nuk është e mundur të mbetemi të shëndoshë, të qëndrueshëm, të pathyeshëm, të durueshëm... nëse bashkohemi me Zotin vetëm atëherë kur na konvenon, apo vetëm atëherë kur jemi ngushtë. Duhet gjithmonë të mbetemi të bashkuar me Krishtin, sikurse Ai është i bashkuar me ne në çdo moment të jetës sonë.

Me ndihmën e Zotit gjithçka mundemi. Kjo frazë ishte dhe është edhe sot e kësaj dite refreni i shenjtërve dhe shenjtëreshave të Zotit. Ata, në mënyrën më të bukur, e kuptuan e iu bindën shëmbëlltyrës së Ungjillit të sotshëm. Për asnjë çast të jetës së tyre nuk i lejuan djallit dhe mashtrimeve të kohës që t'i ndajë nga Hardhia e vërtetë. Sepse ishin më se të bindur se çdo ndarje apo largim, edhe më i vogli që do të mund të ishte, do t'iu sillte atyre vdekjen, tharjen, prishjen dhe humbjen e jetës së tyre.

Fjala e Zotit na bëhet mësuese dhe ndihmë që ta kuptojmë dhe ta jetojmë lidhjen tonë me Zotin. Prandaj duhet t'i lejojmë zemrës dhe mendjes sonë të ushqehet edhe nga kjo Fjalë, e cila dhuron jetën. Gjithashtu edhe sakramentet e shenjta, janë ato mjete të shëlbimit përmes të cilave në mbetemi qysh tashti në këtë botë të bashkuar me Krishtin dhe njëkohësisht premtojnë gëzimin dhe lumturinë me Zotin në jetën e amshuar.

Gjë tjetër shumë e rëndësishme që duhet praktikuar, nëse dëshirojmë të mbetemi gjithmonë të bashkuar me Zotin, është urata.

Ndërmjetësia e Zotit tonë Jezu Krishtit, e nënës së Tij dhe nënës sonë Zojës së Bekuar, si dhe e shenjtërve dhe martirëve tanë, të cilët edhe në momentet më të vështira të jetës së tyre nuk lejuan të ndahen dhe të largohen nga Rruga e Vërteta dhe Jeta, bëftë që edhe ne me shembullin dhe ndihmën e tyre të mbetemi gjithmonë të bashkuar me Jezu Krishtin. Amen.



Lutjet e besimtarëve

Jezu Krisht, Hardhia e vërtetë shermendet e të cilës jemi ne, po t'i paraqesim lutjet tona të përvujta dhe me shpresë po të lutemi: *Dëgjoje o Zot lutjen tonë.*

- Po të lutemi për Kishën shenjte në krye me papën tonë Benediktin e XVI, që ta ndihmosh dhe ta ruash gjithmonë të bashkuar pranë Hardhisë së vërtetë, *të lutemi.*

- Po të lutemi për bashkësinë tonë të krishterë, që të dinë të rritet në fe, shpresë dhe dashuri dhe të bëhet dëshmitare e paqes dhe e faljes, *të lutemi.*

- Po të lutemi për të gjithë ata të cilët janë të prekur nga vuajtjet dhe sëmundjet e ndryshme, që ta gjejnë ndihmën, ngushëllimin dhe dashurinë e Zotit dhe njëri-tjetrit, *të lutemi.*

- Po të lutemi, o Zot, për popullin tonë shqiptar që të kthehet dhe t'i bashkohet Kishës sate të shenjtë. *Të lutemi.*

Pranoji, o Zot, lutjet që t'i kushtuam dhe ato që qëndrojnë në zemrën tonë nëpër Krishtin Zotin tonë. Amen.

Don Anton Ukaj

E diela VI e Pashkëve

Leximi i parë:

Vap 10, 25-27. 34-35. 44-48. Na flet për pagëzimin e paganit të parë, e ky ishte Korneli. Që nga kjo ditë e deri më sot Kisha mundohet t'i sjellë në gjirin e vet të gjithë njerëzit.

Psalmi: 98 (97)

Zoti ua dëftoi popujve drejtësinë e vet.

Leximi i dytë: 1 Gjn 4,7-10.

Përmban mësimin e shën Gjonit për dashurinë e Zotit dhe thirrje në dashurinë e Zotit.

Ungjilli: Gjn 15,9-17.

Në atë kohë, Jezusi u tha nxënësve të vet: *Sikurse Ati më ka dashur mua, ashtu edhe unë ju kam dashur ju. Qëndroni në dashurinë time! Nëse i mbani urdhërimet e mia, do të qëndroni në dashurinë time, sikurse edhe unë që i mbajta urdhërimet e Atit tim dhe qëndroj në të. Jua thashë këto,*

që gëzimi im të jetë në ju e gëzimi juaj të jetë i plotë. Ky është urdhri im: dua jeni njëri-tjetrin sikurse unë ju desha ju! Dashuria më e madhe që ndokush mund të tregojë është:

të japë jetën e vet për miqtë e vet.

Ju jeni miqtë e mi nëse bëni çka ju urdhëroj unë. Nuk ju thërras më shërbëtorë, sepse shërbëtori nuk di

çka bën zotëria i tij; unë ju quajta miq, sepse ju zbulova gjithçka

që dëgjova prej Atit tim. Ju nuk më zgjodhët mua, por unë ju zgjodha ju

dhe ju caktova të shkoni e të jepni fryt e fryti juaj të qëndrojnë; dhe që Ati t'ju japë çka do të kërkonti në Emër tim. Këtë gjë ju urdhëroj;

dua jeni njëri-tjetrin!"

Fjala e Zotit

Në kohën e Pashkëve leximet liturgjike na përcjellin gjithnjë duke na dhënë ndihmë për ta përhëlluar lidhjen/bashkimin tonë me të Ringjallurin. Mbase ky është edhe qëllimi kryesor i ciklit liturgjik, që na përcjell gjithnjë gjatë vitit, por edhe gjatë tërë jetës, si rrugëtim i përhershëm për ta takuar Krishtin e për ta jetuar sa më thellë praninë e tij.

Ja, në këtë linjë takohemi edhe sot me pjesën e ungjillit të Gjonit, përndryshe apostulli më i dashur i Jezusit dhe ai që kishte mbështetur kokën në parzmën e Zotërisë gjatë Darkës së Mbrame. Nga kjo dashuri e veçantë e Jezusit dhe Gjonit ka lindur edhe Ungjilli i tij, dëshmi e gjallë e intimitetit të një apostulli dhe Mësuesit të tij. Aq më tepër kur fragmenti i sotëm është pikërisht fjalimi i Jezusit në kohën e Darkës së Mbrame, para se të dorëzohet për të vuajtur e për tu kryqëzuar. Pra, kemi një fjalim kur Jezusi *çel zemrën* e vet para apostujve *e shpalos krejt dashurinë* e vet ndaj atyre që i kishte zgjedhur.

Të dielën e kaluar kemi dëgjuar pjesën e parë të këtij fjalimi, kur Krishti i thërret apostujt të jenë të lidhur ngushtë me të sikurse që janë të lidhur hardhia me

shermendet. Kjo figurë *hardhi-shermend* na hedh në një aventurë të re të mendimit se çfarë do të duhej të ishte lidhja e apostujve, edhe e jona, me të Ringjallurin. E dimë se shermendi është pjesë përbërëse dhe e pandashme e hardhisë dhe se vetëm ashtu mund të ekzistojë, në të kundërtën do të mbetet i vyshkur, i tharë e pa fryt. Jezusi këtë lidhje dhe qëndrim në të e vendos në Dashuri. E jo një dashuri çfarëdo, por në dashurinë hyjnore, të tillë çfarë ekziston mes Jezusit dhe Atit Qiellor.

Ja gëzimi më i madh e më i plotë që një i krishterë mund ta ketë – të qëndrojë në dashurinë e Jezusit, në zemrën e tij përgjithmonë. Reciprokisht është gëzimi i vetë Jezusit!

Nëse e lexojmë me vëmendje pjesën e ungjillit, atëherë na bëhet e qartë krejt jeta e Jezusit në tokë, na bëhet i qartë mishërimi i tij, vuajtja e tij dhe vdekja e tij në kryq. Gjithçka kishte filluar pikërisht me këtë dashuri të pafund hyjnore që nga shpella e Betlehemit e deri në ditën e fundit të jetës së tij në tokë e që vazhdon të jetë e pranishme edhe sot e gjithnjë e për amshim. Jezusi na tërheq në sferën e hyjnore, na ngrit afër Atit të vet e Atit tonë.

Pa *hirin* e tij s'do të mund ta kuptojmë këtë bashkim e këtë dashuri, e sidomos sot kur dashuria duket se është shndërruar në një akt gati sentimental që keqpërdoret e çkuptimësohet thuajse kudo e prej gjithkujt. Fatkeqësisht, gjithnjë e më shumë takojmë njerëz që pohojnë se për shkak të dashurisë kanë shkëputur dashurinë; për shumë njerëz ajo është bërë shkak ndarjesh e ngatërresash, torturimesh e vrasjesh. Sa larg kanë shkuar njerëzit në përdhosjen e saj, sa që ka edhe të atillë që nuk besojnë më në dashurinë, besnikërinë... duke thënë se ajo është gënjeshtër dhe nuk ekziston fare. Sa e lemerishme është kur dëgjojmë e takojmë këso individësh që kanë humbur ndjenjën e dashurisë fisnike, besnikërinë në dashuri e bredhin në mos dashuri, anke, zhgënjime.

Jezusi sot na drejton kah një rrugë krejt tjetër nga ajo që duket sot se është normale dhe njerëzore. Të duash nuk do të thotë të plotësosh një nevojë biologjike a sentimentale, por diçka më tepër. Të duash do të thotë të hapësh zemrën për tjetrin dhe për Zotin, të dhurosh e të pranosh, të gëzohesh me të tjerët e madje edhe të vuash. *Dashuria më e madhe që dikush mund të tregojë është; të japë jetën e vet për miqtë e vet* (Gjn 15, 13). Për shumëkënd kjo do të ishte ligshiti e çmenduri, por në thellësi kjo qëndron në zemrën e çdo njeriu kur e posedon dhe e jeton dashurinë e vërtetë. Jezusi e ka treguar këtë me jetën e vet. Por edhe shumë të krishterë e kanë treguar gjatë historisë së kishës. Edhe sot ne a nuk vdesim për miqtë tanë e të dashurit tanë. Sa vdekje kemi përjetuar gjatë jetës sonë për ata që i duam, sa vuajtje kemi përjetuar për miqtë tanë?! Porse, krejt varet se kush çka kupton me nocionin dashuri. Ne të krishterët e kemi gjetur kuptimin e plotë e të vërtetë të dashurisë dhe se ajo



tek ne shkruhet me shkronjën e madhe D.

Këtë gjë ju urdhëroj: duajeni njëri-tjetrin. (Gjn 15, 17). Urdhri i Jezusit! *Pa dashuri s'je njeri, pa Zotin nuk je njeri!* Zoti është dashuri, kush do të ketë dashuri do të jetë e do të mbetet në Zotin dhe Zoti në të. Amen.

Lutjet e besimtarëve

T'i lutemi me fe të gjallë Krishtit, i cili e munda vdekjen dhe e ripërtëriu jetën: Dëgjoje, o Zot, lutjen tonë.

Ti që je gur, të cilin ndërtuesit e qitën jashtë përdorimit, e Ati e zgjodhi për gur këndi, bëje secilin prej nesh gur të gjallë për ndërtimin e Kishës sate, *të lutemi.*

Ti që ishe i vdekur dhe tani jeton përgjithmonë, na jep forcë që t'i mbajmë premtimet e pagëzimit për ta merituar kurorën e jetës, *të lutemi.*

Ti që je dëshmitar besnik dhe i vërtetë, bëj që Kisha jote të dëshmojë gjithmonë me fjalë, me vepra dhe me ngjalljen tënde, *të lutemi.*

Na mëso dhe na aftëso të duam Zotin dhe njeri tjetrin siç bëre edhe me apostujt, *të lutemi.*

O Hyj i gjithëpushtetshëm, bëj që këto ditë të Pashkëve të jenë nxitje frymëzuese për të jetuar në jetën tonë. Nëpër Krishtin Zotin tonë.

Don Fatmir Koliqi

Jeta Liturgjike

Boton: SHB "DRITA", Prizren

Kryeredaktor: Don Albert Demaj

Redaksia: At Ilia Kovačević, Don Anton Ukaj, Don Jeton Thaqi

Email: jetaliturgjike@hotmail.com

Telefon: 0280/380-645

Shtyp: www.siprint-ks.com